



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave/ Program i
Integruar në “Arkitekturë”**

ofruar nga

Universiteti “Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof As. Gjergji Islami

Prof As. Odeta Manahasa

Dhjetor / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave Program i Integruar i Nivelit të Dytë në “ARKITEKTURE”**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Barleti"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program i integruar studimi Master i Shkencave në “Arkitekturë”
4	Urdhëri/VKM i liçensimit:	UMAS Nr. 394, datë 06.10.2014
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMAS Nr. 246, datë 30.12.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 114, datë 02.11.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2019-2020 12 PAE / 8 PAK 2020-2021 18 PAE / 7 PAK 2021-2022 17 PAE / 4 PAK 2022-2023 16 PAE / 4 PAK 2023-2024 13 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 21 studentë 2020-2021 24 studentë 2021-2022 30 studentë 2022-2023 58 studentë 2023-2024 43 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Universiteti jopublik "Barleti" ka filluar aktivitetin e tij me 2005 dhe aktualisht është i kompozuar në 4 Fakultete 13 Departamente .

- Fakulteti i Ekonomise, Qeverisjes dhe Drejtesise
- Fakulteti i Shkencave te Aplikuara dhe Industrive Kreative
- Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit
- Fakulteti i Shkencave Mjeksore

Fakulteti i Shkencave te Aplikuara dhe Industrive Kreative eshte i perbere nga 3 departamente:

- Departamenti i Shkencave te Aplikuara dhe Kompjuterike
- Departamenti i Arkitektures dh Dizajnit
- Departamenti i Industrive Kreative

Njësia Kryesore që ofron këtë program studimi është Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative, kurse Njësia Bazë përgjegjëse është Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit, (Sipas shkresës "Informacion mbi mënyrën e organizimit të programeve të studimit sipas Departamenteve në UMB", datë 26.03.2018). Ky program realizohet me 300 kredute dhe me nje kohëzgjatje normale 5(pese) vite akademike dhe me nje kohëzgjatje maksimale prej 10(dhjete)vite akademike. Permbyllja e studimeve finalizohet me nje punim diplome dhe studenti pajistet me siplome " Master i Shkencave" ne "Arkitekture".

Universiteti jopublik "Barleti" ofron studime e kualifikime në diplomat *profesionale*, diplomat *Bachelor*, *Master Profesional* dhe *Master i Shkencave*.

Liçensimi për programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Arkitekturë" është bërë përmes Urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr. 394 me datë 06.10.2014. Ky program ka kryer akreditimin e tij te pare në 2019 dhe ka hyre per here te dyte ne proces akreditimi.

Verehet qe departamenti i Arkitektures dhe Dizajnit ka progres ne rritjen e numrit te studenteve dhe te stafit akademik dhe gjithashtu ka pasur progres ne rritjen e ambjenteve me nje infrastrukture cilesore.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimeve **Program i integruar studimi Master i Shkencave në “Arkitekturë”** filloi me ngritjen e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ). Grupi shqyrtoi dosjen dhe u njoh me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, saktësimin e vlerësimeve dhe me plotësimin e informacioneve të paraqitura në raport. Për të realizuar këto objektiva, GVJ u njoh më së pari me agjendën e vizitës në institucion, e cila u realizua me datat 31 Janar 2023 dhe 1 shkurt 2024.

Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative, Drejtuesen e Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit, grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik, studentët, Njësinë Bazë të Sigurimit të Cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Planifikimit të Karrierës, sekretarisë mësimore, Zyrës së Projekteve etj. Gjithashtu GVJ vizitoi dhe mjediset mësimore, social kulturore e laboratorike ku zhvillohet programi i integruar studimi Master i Shkencave në “Arkitekturë”.

Në këto takime GVJ u njoh më nga afër me nivelin e plotësimin të standardeve të kërkuara, me organizimin, drejtimin dhe administrimin e këtij program. Gjithashtu, u njoh me mënyrën e mësimdhënies, burimet financiare, infrastrukturën, logjistikën për realizimin e programit të integruar të studimit Master i Shkencave në “Arkitekturë”, si dhe punën që bëhet për ruajtjen dhe sigurimin e cilësisë.

Në përfundim të takimeve, GVJ kërkoi dokumente shtesë kryesisht në lidhje me shembuj që lidhen me punët e studentëve; relacion diplome, shembull projekt diplome, shembull nga mbrojtja e praktikës profesionale dhe shembull projekti për Laboratorin e Projektimit Arkitektonik. Pas vlerësimit të të gjitha dokumentave përkatëse, GVJ vijoi me përgatitjen e raportit që vlerëson programin e integruar të studimit Master i Shkencave në “Arkitekturë”.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.114, datë 02.11.2019 janë:

- Institucioni, të rekrutojë/angazhojë staf të ri akademik në këtë program studimi, me qëllim uljen e ngarkesës së lartë mësimore të stafit akademik aktual të përfshirë në këtë program studimi.
- Institucioni, të shtojë në bibliotekën e Institucionit, tituj në fushën e arkitekturës në funksion të realizimit të këtij program studimi.
- Institucioni, të përmirësojë në terma fizike dhe nivel mobilimi ambientet e dedikuara laboratorëve të projektimit.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

- Ndryshimet në numrin dhe kualifikimin e personelit akademik kanë sjellë një reduktim të lehtë ngarkesës mësimore dhe të numrit të disiplineve në të cilat përfshihet personeli akademik. **Rekomandimi është përmbushur kryesisht.**
- Institucioni rezulton se ka bërë përpjekje minimale për zgjerimin e fondit fizik në fushën e arkitekturës. Nevojitet angazhimi në vijimësi për plotësimin e këtij rekomandimi. **Rekomandimi është përmbushur pjesërisht.**
- Ndërtesa e re e universitetit ka adresuar rekomandimin për cilësinë fizike të laboratorëve të projektimit. **Rekomandimi është përmbushur plotësisht.**

Më datë 03.12.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.45/34 Prot., datë 03.12.2024 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 11.12.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr.45/40 Prot., datë 13.12.2024, ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ, pasi u njoh me komentet e Universitetit Barleti, për secilin prej standardeve, sqaron si më poshtë:

Standardi III.1, Kriteri 3

Duki iu referuar evidencave të paraqitura nga komenti i institucionit, vërehet që institucioni mundohet të mbështesë stafin akademik me anë të mobiliteteve dhe bashkëpunimeve akademike. Komenti pranohet dhe sugjerimi është reflektuar me ndryshim në raport.

Standardi III.1, Kriteri 6

Komenti i ardhur nga institucioni nuk është në përputhje me kërkesat e standardit, i cili flet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies me anë të eksperimentimit apo zhvillimit të metodave të reja. Sugjerimet e dhëna kanë qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Një Bashkëpunim me Sigurinë e Brendshme të Cilësisë në organizimin e punëtorive me tematike të standardit në fjalë, do të kontribuonte në përmbushjen e këtij kriteri. Raporti nuk pëson ndryshime.

Standardi III.1, Konkluzione

GVJ e shpreh më lart qëndrimin e tij. Raporti nuk pëson ndryshime.

Standardi III.4, Kriteri 1 dhe Konkluzione

Institucioni pranon sugjerimin e GVJ në lidhje me mungesën e veprimtarive të kategorisë (C). Raporti nuk pëson ndryshime.

Standardi IV.1, Kriteri 5

Komenti i universitetit nuk përputhet me deklarinin në tabelën 1 (A.3.15). Raporti nuk pëson ndryshime.

Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit	7	(0) Prof. Dr. (3) Prof. Asoc. Dr. (2) Dr. (0) Dr.proc. (2) MSc.	2	(0) Prof. Dr. (0) Prof. Asoc. Dr. (2) Dr. (0) Dr.proc. (0) MSc.	0	9
--	---	---	---	---	---	---

Standardi IV.1, Konkluzione

Komenti i universitetit bie ndesh me parashikimet e Ligjit 80/2015 Neni 59, Pika 6. Raporti nuk pëson ndryshime.

6. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Në kolegjet profesionale të larta, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku diplomën "Master profesional".

Standardi IV.3, Kriteri 3 dhe Konkluzione

Funksionimi i bibliotekës, cilësia e fondit dhe shkalla e përdorimit të tij ilustrohen në raport. Raporti nuk pëson ndryshime.

Standardi IV.5, Kriteri 2 dhe Konkluzione

Universiteti nuk shprehet qartë nëse nuk është dakord me vlerësimin e GVJ. Standardi IV.5 është vlerësuar se përmbushet plotësisht. Raporti nuk pëson ndryshime.

KREU IV

Universiteti sugjeron rishikimin e kriterit III (mendojmë se bëhet fjalë për Standardin IV.3). GVJ është përgjigjur më sipër për këtë. Raporti nuk pëson ndryshime.

Standardi VI.4, Kriteri 1 dhe Kriteri 5 dhe Konkluzione

Universiteti nuk shprehet qartë nëse nuk është dakord me vlerësimin e GVJ. Sugjerimet e dhëna kanë qëllim përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë. Raporti nuk pëson ndryshime.

Standardi VI.5, Kriteri 2 dhe Kriteri 3

Në komentin për këtë standard, universiteti shprehet se “Institucioni ka respektuar plotësisht standardet e vlerësimit të brendshëm, ...”. GVJ ka argumentuar në raport qëndrimin e tij. Raporti nuk pëson ndryshime.

Standardi VI.5, Kriteri 4, Kriteri 5 dhe Konkluzione

GVJ ka argumentuar në raport qëndrimin e tij. Sugjerimet e dhëna kanë qëllim përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë. Raporti nuk pëson ndryshime.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave/ Program i Integruar i Nivelit të Dytë në “Arkitekture”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Të gjitha aktivitetet e Universitetit “Barleti” janë drejtuar të gjitha nga misioni për të qenë një institucion arsimor dhe kërkimor inovativ dhe me ndikim, duke u shërbyer vlerave themelore njerëzore përmes prodhimit, zhvillimit dhe shpërndarjes së njohurive në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe duke kontribuar në përmirësimi i cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale (<i>Evidenca A.1.1: Statuti i IAL-së, neni 7</i>). Në këtë kontekst, Universiteti “Barleti” ofron programe studimi që korespondojnë me interesat kombëtare. Universiteti “Barleti” përmes programeve të tij të studimit, synon të përgatisë individë të kualifikuar, të cilët janë profesionalisht produktivë dhe kompetent, të orientuar drejt tregut të punës, të ndjeshëm ndaj shoqërisë dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky program studimi është në përputhje me interesin kombëtar për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni i Universitetit “Barleti” synon të ketë programe akademike të pasur dhe gjithëpërfshirës duke krijuar përvojë aktive të studentët, kërkim shkencor të aplikuar (<i>Evidenca A.1.4: Strategjia e Zhvillimit të IAL-së, Pika. 3.1.1</i>). Në këto terma, Programi i Ciklit të Dytë PI Master i Shkencave në “Arkitekturë” është në përputhje me misionin e institucionit.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Universiteti “Barleti” është një institucion arsimor dhe kërkimor në shërbim të vlerave njerëzore. Ai synon të aftësojë profesionistët e ardhshëm në analizimin kritik të territorit, në projektimin e qëndrueshëm arkitektonik, në planifikim urban, në ruajtjen e vlerave kulturore e historike dhe në menaxhimin e pasurive të paluajtshme lokale (<i>Evidenca A3.11.</i>). Programi zbatohet në përputhje me Planin Strategjik të departamentit (<i>Evidenca A3.11</i>), Statutin e IAL-së, Neni 6 me qëllim inovacionin, kërkimin dhe praktikën e aplikimit, si dhe me synimet e Republikës së Shqipërisë.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet	Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë në Arkitekturë përbëhet nga kurse që trajtojnë ndër të tjera nevojën për kërkime

në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	shkencore dhe aftësi profesionale në fushën e arkitekturës dhe kontribuojnë në tregun e ndërtimit në Shqipëri. Konkretisht, informacion më të thelluar e vëmë re në planin mësimor të Programit të Integruar të Ciklit të Dytë të Studimit në Arkitekturë” (Evidenca A3.3.2). Dosja e plotë e programit të studimit me përbërësit e tij (Plani mësimor i programit të studimit) ofron lëndë, të cilat synojnë të sigurojnë që programi të përafrohet me prioritetet e zhvillimit të Shqipërisë.			
Konkluzione	<i>Programi është i strukturuar në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe kontribuon në ofrimin e profesionistëve të kualifikuar që plotësojnë kërkesën e tregut të punës dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Stafi akademik sjell kapacitetet dhe përvojën e duhur në ofrimin e programeve të studimit me cilësi të lartë. CV-të e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit PI të ciklit të dytë në Arkitekturë (Evidenca A. 3.4) dhe “Të dhënat tabelore për personelin akademik të angazhuar në programin e studimit PI të ciklit të dytë në Arkitekturë (Evidenca A 3.15 Aneks tabelat përmbledhëse , Tabela 1, 2, dhe Tabela 6) tregojnë se institucioni ka burime, kapacitete dhe përvojë për të ofruar programin e studimit.</p> <p>FSHAIK në vitin akademik 2023-2024, ka gjithsej 35 pedagogë, nga të cilët 23 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 12 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>4</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>		Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative		PAE	PAK	Prof.Dr	1	0	Prof.Asoc	4	0
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative												
	PAE	PAK											
Prof.Dr	1	0											
Prof.Asoc	4	0											



	Dr/PhD	7	2
	Msc	11	10
	Gjithsej	23	12
<p>Ndërsa Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024, ka këtë paraqitje:</p>			
	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit	
		PAE	PAK
	Prof.Dr	0	0
	Prof.Asoc	3	0
	Dr/PhD	2	2
	Msc	2	0
	Gjithsej	7	2
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha specifike dhe e përgjithshme e programit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore. Kjo shprehet në rregulloren e FSHAIK (<i>Evidenca A2.1</i>) por edhe u evidentua nga takimi me grupin e vlerësimit të brendshëm pranë IAL-së. Ndërkohë, duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion (<i>Evidenca A.1.31</i>), institucioni është duke punuar për përgatitjen dhe kodifikimin sipas Udhëzimit të MAS Nt. 31, datë 15.11.2022. Ky program rezulton i hartuar në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në “Strategjinë Kombëtare për Arsimin e Lartë” të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe me procesin e Bolonjës.</p>		
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore,</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, vihet re që fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij program studimi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, kjo e fundit në përputhje me strategjitë e Universitetit “Barleti” (<i>Evidenca A3.11</i>). Programi i studimit pajis studentët me njohuri dhe aftësi të avancuara dhe të specializuara.</p>		

të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.									
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk aplikohet.								
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Institucioni ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit publikë, privatë dhe jofitimprurës në Shqipëri për të kryer dhe mbështetur trajnime, praktika, forume të hapura, vizita në kompani për studentët. Institucioni disponon një strukturë të pavarur (Qendra e Trajnimeve dhe Testimeve Barleti) e cila është përgjegjëse për organizimin e këtyre trajnimeve. Qendra e Trajnimeve dhe Testimeve Barleti si dhe Zyra e Alumnit dhe Karrierës ndihmojnë studentët duke koordinuar trajnime të ndryshme për zhvillimin profesional dhe praktik. Kjo shprehet në objektivat e Planit Strategjik të Alumni dhe Karrierës (<i>Evidenca A.1.33.8</i>) si dhe nga takimet me studentet apo dhe me Zyrën e Karrierës.								
Konkluzione	<i>Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë në Arkitekturë në Universitetin “Barleti” ofrohet nga Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit i cili është një nga tre departamentet e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative. Ky program është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë, përgjegjëse për programin e studimit në kete institucion.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të	Njësitë (departamentet) bazë organizojnë veprimtarinë mësimore-kërkimore dhe njësitë (fakultetet) kryesore bashkërendojnë veprimtarinë e njësisë bazë që përfaqësojnë. Institucioni garanton një marrëdhënie bashkëpunimi të frytshëm nëpërmjet ndarjes së

<p>frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>detyrave ndërmjet stafit të tij dhe përbushjes së përgjegjësive përkatëse. Siç parashikohet në rregulloren e Universitetit “Barlet” (<i>Evidenca A.1.3</i>), secila njësi ka detyra dhe objektiva që së bashku përbushin misionin e institucionit.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe kontakti i drejtpërdrejt me stafin e angazhuar të njësisë përgjegjëse për programin e studimit, si dhe autoritetet drejtuese mund të pohohet se njësitë janë të angazhuara maksimalisht dhe të ndërgjegjshme për nevojat dhe objektivat e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Universiteti “Barleti” ka realizuar një numër të gjerë bashkëpunimesh me institucione partnere vendas dhe të huaj (<i>Evidenca A.1.35</i>). Po ashtu institucioni ka marrëveshje me aktore të biznesit me të cilët organizon punëtori dhe siguron praktikant studentore (<i>Referuar tabelës 5 të RVB-së</i>). Kjo u artikulua edhe gjatë takimit në institucion me stafin e programit por edhe nga takimin me studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Universiteti bashkëpunon me universitetet e BE-së përmes Programit Erasmus+ dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh dhe inkurajon studentët të marrin pjesë në programet e shkëmbimit ndërkombëtar. Institucioni ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit publikë, privatë dhe jofitimprurës në Shqipëri për të kryer dhe mbështetur praktikën profesionale të studentëve.</p> <p>Te gjitha këto janë të pasqyruara në raportet e kërkimit shkencor të Departamentit të Arkitektures dhe Dizajnit në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative. (<i>Evidenca A3.4.9; A3.4.9b; A3.4.10</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet</p>	<p>Në kuadër të analizës së ecurisë së programit, Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit, harton raporte periodike analitike në të cilat analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat, duke përfshirë edhe fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p>

e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në <i>Evidencat A3.4.1, A3.4.2 dhe A3.4.3</i> , të cilat përmbajnë analizat dhe raportin vjetor të tre viteve të fundit, shprehen objektivat e bashkëpunimeve dhe disa nga arritjet.			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj kryesisht në kuadër të aftësisë profesionale. Nga vizita në institucion dhe kontakti i drejtpërdrejt me stafin e angazhuar të njësisë përgjegjëse për programin e studimit, si dhe autoritetet drejtuese, por edhe me studentët mund të pohohet se të gjitha hallkat janë të angazhuara dhe bashkëpunojnë për kryerjen e praktikave me qëllim zhvillimin profesional të studentëve. Nga ana tjetër, kërkimi shkencor dhe mobilitetet fokusohen më shumë në kuadër të stafit akademik të cilat përkthehen në marrëveshje bashkëpunimi por edhe në rritjen e cilësisë akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit i ciklit të dytë (300 kreditë) Master i Shkencave (Program i Integruar) në “Arkitekturë” ka si synim formimin e profesionistëve të kualifikuar në fushën e arkitekturës në përgjigje të kërkesave bashkëkohore. Universiteti “Barleti” ka përcaktuar misionin dhe objektivat e programit të studimit, përmbajtjen e programit dhe rregulloren e programit (<i>Evidenca A.3.1</i>). Gjithashtu në dokumentacionin e paraqitur dhe nga rezultatet e vizitës në institucion rezulton se organizimi i vitit mësimor, semestrave, planeve mësimore (<i>Evidenca A.3.2.2</i>) me të gjithë komponentët e tij (modul, kriteret, përcaktimi i orëve brenda dhe jashtë auditori) janë të mirë paraqitura. Lëndët janë të gjitha të pajisura me

	syllabuset (<i>Evidenca A.3.16</i>) përkatës ku janë shprehur qartazi nevojat dhe kriteret që formulojnë modulën.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Duke iu referuar kurrikulës (<i>Evidenca A.3.3.2</i>) së programit të studimit i lejon studentët të maturohen dhe të arrijnë aftësi të përgjithshme dhe aftësi të veçanta mbi profesion. Kurrikula gjithashtu i pajis me aftësi të të kuptuarit kritik që i lejon studentët të përfshihen dhe të kuptojnë terma teknikë dhe shkencor të arkitekturës, si dhe të përdorin shprehje specifike në një gamë të gjerë specialitetesh profesionale në fushë. Në të vërtetë, kjo korespondon me Nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Programi ofron njohuri të avancuara në fushën e studimeve të Arkitekturës, duke përfshirë një kuptim kritik të teorive dhe koncepteve, parimeve dhe terminologjisë kryesore didaktike. Duke iu referuar takimeve në institucion, ky program i jep një fokus të veçantë “arkitektit aplikativ” dhe përgatitjes së profesionistëve të cilët kanë aftësi të aplikojnë metoda dhe teknologji bashkëkohore. Për këtë të fundit, institucioni ofron laboratorë bashkëkohorë, ndërkohë rekomandohet të punohet më shumë me kurrikulën në ofrimin e lëndëve aplikative dhe në shtimin e lëndëve me zgjedhje në këtë drejtim.
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Referuar planit mësimor (<i>Evidenca A.3.3.2</i>), praktika profesionale ka një ngarkesë të caktuar prej 4 kreditesh ECTS dhe është kusht i detyrueshëm për diplomim. Përsa i përket detyrimeve përmbyllëse, studenti diplomohet pasi ka marrë 300 kredite ETC dhe ka kaluar me sukses provën finale (<i>Evidenca A 3.2.1, Kreu IV, neni 22</i>).
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Ky kriter nuk aplikohet
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e	Ky kriter nuk aplikohet

<p>mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Institucioni nuk ka pasur raste të regjistrimit të studentëve me status të veçantë.</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Provat tregojnë se asnjë IAL tjetër ofron të njëjtin program me të njëjtën emërtesë. Edhe pse IAL-të e tjera kanë program 5 vjeçar me 300 ECTS ngjashmëria qëndron në trajtimin e projektit përfundimtar dhe kjo ngjashëri nuk arrin 70% të nivelit të ngjashmërive në përmbajtje!</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Kodifikimi kombëtar i programeve të studimit, sipas Udhëzimit të MAS Nr.31, date 15.11.2022 është ende në proces. Universiteti “Barleti” vërteton angazhimin për përgatitjen e kodifikimit dhe dorëzimin brenda afateve të përcaktuara (<i>Evidenca A.1.3</i>). Megjithatë institucioni ka zbatuar kodifikimin e tij të programeve dhe kurseve të studimit në përputhje me fushën specifike të studimit.</p>

Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Arkitekturë”, nuk është në bashkëpunim me institucione të tjera, por ofrohet vetëm nga Universiteti “Barleti”.			
Konkluzione	<i>Brenda këtij standardi, GVJ arrin në përfundimin se programi i integruar i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Arkitekturë”, është i organizuar sipas ligjit aktual për arsimin e lartë, sipas rregullores së brendshme të programit dhe sipas statutit të IAL-së. Ky program ofrohet vetëm në Universitetin “Barleti” dhe ka fokus të veçantë përgatitjen e “arkitektit aplikativ” dhe respekton Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 41, datë 24.01.2018.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2				
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative përbëhet nga 3 departamente (njësi bazë), duke plotësuar detyrimin ligjor për ekzistencën e tij (<i>Evidenca A.2.1</i>). Të dhënat e vëna në dispozicion ndaj grupit të vlerësuesve tregojnë një mos-stabilitet të stafit të punësuar, por demonstrojnë politikë rekrutuese që tenton drejt personelit me grada e tituj shkencore. Ndërkohë përmes mbështetjes që i jep stafit institucioni, vihet re kualifikimi i vazhduar i tyre. Pavarësisht kësaj, duke iu referuar ngarkesës së stafit të brendshëm (numrit të disiplinave që mbulon një pedagog) rekomandohet shtimi i numrit të personelit të kategorisë lektor. Ky program është akredituar për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 114, datë 02.11.2019.			
	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative në tre vite akademike ka përbërjen si më poshtë :			
		2021-2022	2022-2023	2023-2024

Kualifikimi i stafit akademik të FSHAIK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	-	-	-	1	-
Prof. Asoc.	-	1	-	-	4	0
Dr/Phd	9	3	9	3	7	2
Msc.	17	4	14	6	11	10
Gjithsej	26	8	23	9	23	12

GVJ konstaton se bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, personeli akademik i departamentit e DAD i cili ofron këtë program studimi në pesë vite akademike paraqitet si më poshtë:

Stafi akademik i DAD	Prof.Dr.	Prof.As.	Dr/PhD	Msc.	Total PAE/PAK
2019-2020	0 / 0	0 / 0	3 / 3	5 / 5	8 / 8
2020-2021	0 / 0	0 / 0	4 / 3	7 / 3	11 / 6
2021-2022	0 / 0	0 / 0	3 / 2	5 / 0	8 / 2
2022-2023	0 / 0	0 / 0	3 / 3	5 / 0	8 / 3
2023-2024	0 / 0	3 / 0	2 / 2	2 / 0	7 / 2

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Nga vizita në institucion , përmes kontakteve të drejtpërdrejta me stafin dhe studentët vërehet angazhimi i stafit akademik, është i plotë në lidhje me nevojat e programit të studimit. Ndërkohë stafi ndihmës-administrativ nuk është prezent. *(Aneks tabelat përmbledhëse tabelat 1, 2, 6.)* Zyra e karrierës dhe alumni, sekretaria, koordinatori i programit zyra e burimeve njerëzore apo e cilësisë paraqesin tablonë e një stafi të angazhuar për mbarëvajtjen e proceseve mësimore dhe kërkimore.

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit

Nëpërmjet një urdhri të brendshëm të rektorit të Universitetit “Barleti” është caktuar një anëtar i stafit akademik në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij *(Evidenca A3.1 dhe A.3.20.2)*. Nga vizita në institucion dhe kontakti i drejtpërdrejtë me stafin e angazhuar të njësisë përgjegjëse për programin e studimit, si dhe

dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	autoritetet drejtuese mund të pohohet roli kritik i koordinatores së programit.			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Duke iu referuar mos-stabilitetit të stafit të punësuar dhe ngarkesës së stafit akademik sugjerojmë të punohet me Kriterin 1 dhe Kriterin 2 të këtij standardi. Vlerësojmë politikën rekrutuese që tenton drejt personelit me grada e tituj shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia bazë dhe ajo kryesore janë në koordinim të vazhdueshëm kjo u evidentua nga takimet në institucion. Ato kanë informacionin e nevojshëm për organizimin dhe përmbajtjen e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Arkitekturë". Departamenti dhe çdo anëtar i stafit akademik/administrativ ka akses të plotë në dokumentet e si Statuti, rregulloret, kurrikulat, planin mësimor, si dhe aktet e tjera. (https://umb.edu.al/dossier-uniba.html).
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit të Dytë, program i integruar, kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të dytë është 5 vite akademike ose dhjetë semestra për Programin e Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë, MSC në Arkitekturë. Kurrikula e programit përmban informacionin e nevojshëm për lëndët semestrale, ngarkesën mësimore të lëndëve dhe orët brenda dhe jashtë auditorit (<i>Evidenca A.3.3.2</i>). Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë MSc. në Arkitekturë ka një plan-program të detajuar, i cili përfshin informacionin e nevojshëm për lëndën/lëndët e semestrit, ngarkesën e mësimdhënies, orët brenda/jashtë klasave, frekuentimin/përcjelljen e programit, metodat e vlerësimit të njohurive, organizimin në module dhe çdo informacion të nevojshëm, në bazë semestrale (<i>Evidenca A.3.16 ku gjenden një pjesë e silabuseve</i>).

<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë Msc. në Arkitekturë u ofron studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. (<i>Evidenca A.3.2.1 dhe A.1.22</i>). I gjithë infromacioni është në dossierin e Universiteti (https://umb.edu.al/dossier-uniba.html)</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Ky program studimi ka një plan-program të detajuar, i cili përfshin informacionin e nevojshëm për ngarkesën e mësimdhënies, orët brenda/jashtë klasave, frekuentimin/përcjelljen e programit, metodat e vlerësimit të njohurive, etj. Ai gjithashtu përmban të gjitha kërkesat për cilindo nga programet lëndore (syllabus) për çdo lëndë. Plan-programet, të plotësuara në një format të miratuar, ofrojnë të gjithë informacionin në lidhje me leksionet, vizitat në terren, punëtoritë dhe praktikat. Disa nga syllabus-et mungojnë. (<i>Evidenca A3.16</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Përmbajtja e programit ka ndryshime brenda 20% te strukturës së programit të akredituar. Vihet re heqja e lendes “ Fotografji dhe Analize” dhe e lendeve me zgjedhje. Gjithashtu është shtuar lëndët “Metoda Kërkimore” dhe “Sociologji”.</p> <p>Ndërkohë, duke iu referuar vizitës në institucion, syllabuset në fillim të çdo viti akademik miratohen me ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe takimeve në institucion, GVJ është e mendimit se ky program studimi ka një plan-program të detajuar, i cili përfshin informacionin e nevojshëm për ngarkesën e mësimdhënies, orët brenda/jashtë klasave, frekuentimin/përcjelljen e programit, metodat e vlerësimit të njohurive. Gjithashtu programi tregon angazhimin e njësisë bazë për përditësimin e vazhdueshëm të kurrikulës brenda kornizës ligjore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

19

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Përcaktimi, përmbajtja e aktiviteteve, praktika dhe trajnimi mundësojnë dhe thellojnë njohuritë dhe aftësitë për studime të mëtejshme dhe/ose punësim të studentëve. Gjithashtu, shpërndarja e lëndëve në dhjetë semestra (pesë vjet) ndjek përparimet përkatëse si në profesion ashtu edhe në kërkim. I gjithë informacioni tregohet qartë në plan programet e lëndëve. Syllabuset e programeve të studimit (<i>Evidenca A3.16</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Sipas kuadrit ligjor kombëtar (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018), një kredit (ECTS) korespondon me 25 orë pune të një studenti dhe sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimi për një student është 60 (gjashtëdhjetë) ECTS ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë pune të studentit, duke përfshirë orët në klasa dhe orët e punës së pavarur. Lëndët si dhe shpërndarja e tyre gjatë gjithë viteve dhe në 10 (dhjetë) semestra kontribuojnë në arritjen graduale dhe në rritje të njohurive, aftësive dhe kompetencave të nevojshme nga studentët si dhe në arritjen e rezultateve të kërkimit shkencor. (<i>Evidenca A3.1.6 dhe A3.3.2</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë MSc. në Arkitekturë, lëndët dhe emërtimet, kreditet dhe raporti teori e praktikë janë në përputhje me profilin e programit (<i>sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 për veprimtaritë formuese</i>) (<i>Evidenca A3.1.6 dhe A3.3.2</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e</p>	<p>Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë MSc. në Arkitekturë, lëndët dhe emërtimet, kreditet dhe raporti teori e praktikë janë në përputhje me profilin e programit (<i>sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 për veprimtaritë formuese</i>) (<i>Evidenca A3.1.6 dhe A3.3.2</i>).</p>

objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Vërehet një mungesë balance midis dy semestrave të vitit të katërt në orët në auditor. Konkretisht semestri i parë 15 orë në auditor dhe ai i dytë 24 orë në auditor. Sugjerohet një balancim i orëve në këtë drejtim. (Evidenca A3.3.2).			
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Silabuset e programeve të lëndëve përditësohen vazhdimisht (në fillim të çdo semestri) bazuar në literaturën e kërkuar dhe të rekomanduar të 5 viteve të fundit. (Evidenca A3.1.6)			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e lëndëve, aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe metodat e vlerësimit janë përshtatur me rezultatet e të nxënit dhe kompetencat e programit të studimit. (Evidenca A3.1.6 dhe A3.3.2).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit është e përshtatshme për mundësimin e vijimit të mëtejshëm të studimeve. Studentët e këtij programi kanë një lidhje të mirë midis dijeve teorike dhe praktike. Institucioni ka vënë në dispozicion një numër ambientesh për të kryer praktika mësimore sipas kërkesave bashkëkohore të tregut. Duke iu referuar vizitës në institucion dhe shtojcës 29, mbi infrastrukturën, laboratorët e ndryshëm janë në përshtatje me zhvillimet teknologjike që kërkon tregun.			
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Përmbajtja e programit siguron njohuri të mjaftueshme për formim teorik dhe shkencor. Studentët e diplomuar nga ky program janë të aftë të përballen me tregun e punës ose të vazhdojnë studimet e tyre në ciklin e tretë të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Duke iu referuar takimeve në institucion zyra Alumni, për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, konsultohet dhe merr parasysh propozimet të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. Gjithashtu duke iu referuar takimit në institucion, vihet re që në kuadër të projekteve partnere që ka programi janë ofruar disa ambiente të cilat përmirësojnë cilësinë e programit të studimit. Ndërkohë po ti referohemi analizës së studimit të tregut, vihet re që prioritet i maturanteve është disiplina e arkitekturës por me fokus Interierin (<i>evidenca A.3.8</i>). Sugjerohet të merret parasysh për përmirësimin e plan programit propozimet e analizës së tregut.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti inkurajon përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse të universitetit për të mbështetur të drejtat e studentëve si dhe për të ndarë shqetësimet e tyre për të përmirësuar organizimin dhe funksionimin e universitetit. Në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe Statutin e Universitetit “Barleti”, (Senati ka nga një student për çdo fakultet. <i>Evidenca A.1.1</i>), studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse të Universitetit nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Duke iu referuar RVB-së, Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit, angazhohet në një përpjekje për të përmirësuar programin e studimit. Siç u përmend edhe në kriterin 1 të këtij Standardi, Institucioni mban kontakte me të diplomuarit dhe bën analiza të tregut për tu njohur me ndryshimet e mundshme në fushën e arkitekturës. Gjithashtu, duke iu referuar takimeve në institucion, departamenti ka dhe bashkëpunime të ndryshme me rrjetë profesionistësh të cilët, herë pas here bëhen pjesë e programit me anë të forumeve të hapura. Megjithatë, përshtatja, brenda 20%, e programit të studimit sugjerohet të bëhet duke iu referuar këtyre analizave.</p>

Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve kjo është e dukshme nga forumet e hapura të organizuara me lidhjet dhe bashkëpunimet me profesionistët. Megjithatë , sugjerohet që për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat të merren parasysh propozimet e analizës së tregut dhe të shfrytëzohet rrjeti i bashkëpunimit me ekspertet e fushës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit bazohet në një studim 5- vjeçar që çon në diplomë Master me theks në njohuritë bazë të disiplinës (shprehur në <i>Evidencën A3.2.1, Neni 2-3</i>). Programi ka si synim edhe kërkimin shkencor, në përputhje me objektivat e institucionit, edhe pse në takimet në institucion u theksua “arkitekti aplikativ”.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative inkurajon, koordinon dhe administron veprimtaritë mësimore, kërkimore dhe artistike, duke iu përmbajtur lirisë akademike të stafit akademik (Statuti i Universiteti “Barleti”, <i>Evidenca A1.1, neni 3</i>). Gjithashtu departamenti në bashkëpunim me Fakultetin inkurajojnë kërkimin, zbatimin e projekteve kërkimore dhe organizimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Duke iu referuar takimeve me studentët dhe me stafin akademik të Universitetit “Barleti” si dhe me zyrën e projekteve evidentojmë se programi i studimit nxit dhe motivon studentët për të qenë pjesë e shkëmbimeve në kuadër të projekteve ERASMUS+ dhe kërkimeve shkencore duke qenë pjesë i disa projekteve bashkë me lektorët. (<i>Evidenca A3.4.7, 3.4.8 dhe 3.4.9</i>)
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet	Duke iu referuar RVB-së, (<i>evidencave A.3.15, tabela 18 dhe A3.4.8, A3.4.8, A3.4.9</i>) dhe takimeve në institucion, vihet re që institucioni ofron mbështetje për stafin akademik në organizimin e aktiviteteve

financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	të ndryshme. Gjithashtu mbështet financiarisht pjesëmarrjen e stafit të saj akademik në konferenca ndërkombëtare.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe përpqet në orientimin e studentëve drejt kërkimit shkencor. Gjithashtu departamenti në bashkëpunim me Fakultetin inkurajojnë kërkimin, zbatimin e projekteve kërkimore dhe organizimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare. GVJ konstaton se institucione mbështet akademikisht dhe financiarisht stafin akademik për kërkime shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Duke u bazuar në RVB-në e UniBa, institucioni synon të investojë në projekte kërkimore. Raporti i vitit 2021-2022 (<i>Evidenca 3.4.9</i>) thekson se gjatë vitit akademik stafi ka angazhim në kërkim shkencor. Gjithashtu, nga dokumentacionet e vendosura në dispozicion, si dhe nga takimet me stafin akademik, vihet re rëndësia që i jepet kërkimit shkencor në rang institucional. Si shembull përmenden njësia BRIDGE. Për t'i ardhur në ndihmë stafit dhe jo vetëm, puna kërkimore në UniBa funksionon nën drejtimin dhe orientimin e Koordinatorit për Kërkim dhe Inovacion. Ky i fundit krijon lidhjen ndërmjet Departamenteve dhe strukturave të kërkimit dhe koordinon zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Duke iu referuar evidencave të vendosura në të njëjtin kriter të dosja RVB, vihet re një pjesëmarrje aktive në kërkim. Sërish njësia bazë angazhohet për tu bërë urë lidhëse me institutet kërkimore të Grupit Barleti. Ndërkohë, <i>mungojnë evidencat për numrin e kërkimeve shkencore në procesin mësimor dhe studentët e përfshirë në to.</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia	Në fushën e Arkitekturës, njësia përgjegjëse organizon konferenca dhe aktivitete, të cilat ndihmojnë stafin akademik në arritjen e

përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	objektivave të tyre. Duke iu referuar (<i>Shtojcës A.3.15</i>), përkatësisht ne tabelat 19 dhe 20, të cilat japin vlera numerike të aktiviteteve në vitet e fundit, theksohet të jenë organizuar 3 Konferenca ndërkombëtare dhe 20 punëtori. Gjithashtu theksohet që numri i leksioneve dhe seminareve me lektore të huaj është 8 (tetë).			
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Nga shqyrtimi i plan programit (<i>Evidenca A.3.3.2</i>) dhe i syllabuseve (<i>Evidenca A.3.16</i>) vihet re që një vëmendje e veçantë i kushtohet aftësive të studentëve për punësim, si aftësitë e projektimit, njohja e softuerit specifik për hartim dhe vizualizim, njohja e specifikave të tregut të ndërtimit në Shqipëri dhe theksit që i vë institucioni: arkitekt aplikativ.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Profesioni i arkitektit është i rregulluar në bazë të ligjit https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/LIGJ_NR_10_171_PRR.pdf . Duke iu referuar takimeve në intitucion mund të themi që studentët njihen dhe informohen me kompetencat e nevojshme për marrjen e licensës.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Duke iu referuar “Professional Qualifications Directive 2005/36/EU, article 46” (https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32005L0036) theksohet që trajnimi i arkitektit duhet të jetë i nivelit universitar dhe i të cilit arkitektura është komponenti kryesor. Ky edukim duhet të mbaj balancë midis aspekteve teorike dhe praktike të trajnimit arkitektonik dhe të garantoj përvetësimin e një sërë njohurive dhe aftësive të listuar në kriter. Në këtë aspekt, ky program i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore			
Konkluzione	<i>Duke u bazuar në RVB-në konstatohet se stafi akademik merret me angazhime akademike. Këto lloj aktiviteteve janë përgjithësisht të lidhura me institutet kërkimore të UniBa. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ekspertet mendojnë se duhet paraqitur me shumë përpjekje departamentale për angazhimin e studentëve në aktivitetet lidhur me kërkimin shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet dhe orët në auditor për të pesë vitet janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Leksione <input type="checkbox"/> Seminare / Ushtrime <input type="checkbox"/> Laboratorë <input type="checkbox"/> Praktikë profesionale <input type="checkbox"/> Tezë Diplome <p>Lëndët në syllabuset përkatëse tregojnë shpërndarjen e duhur të të gjithë komponentëve mësimorë, duke përfshirë leksione, seminare, punë laboratorike dhe detyra (bazuar në natyrën e lëndës).</p> <p>Këto komponentët janë të gjithë të miratuar nga IAL dhe janë në përputhje me rregulloret. (<i>Evidenca, A.3.2.1, Evidenca A.3.3.2, Evidenca A.3.16</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nga vizita në institucion, vihet re që personeli akademik i përgjigjet nevojave të studentëve si në ofrimin e njohurive teknologjike (laboratorët dhe hapësirat në dispozicion (<i>Evidenca A.3.19</i>) po ashtu, aktivitetet institucionale janë të dizajnuara në një mënyrë që shtojnë njohuritë dhe aftësitë që studentët marrin në mjediset e klasës.</p> <p>Nga biseda në institucion me studentët, konstatohet një numër i konsiderueshëm aktiviteteve (Leksione publike, Forume të hapura dhe Workshope (<i>Evidenca A.1.36</i>) ku studentët janë aktive.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe</p>	<p>Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. Si evidencë janë mobilitet e ndryshme ku stafi është i angazhuar (<i>Evidenca A.3.4.1-A.3.4.2; A.3.15</i>).</p>

<p>në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentit mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion , përmes kontakteve të drejtpërdrejta me stafin dhe studentët vërehet se angazhimi i stafit akademik është i plotë në lidhje me nevojat e programit të studimit. Në funksion të performancës një pjese e tyre ka angazhim në disa procese në përputhje me nevojat e programit të studimit. Koordinator i programit zyra e burimeve njerëzore apo e cilësisë paraqesin tablonë e një stafi të angazhuar për mbarëvajtjen e proceseve mësimore dhe kërkimore. Studentët fillojnë që nga viti i parë të punojnë në përgatitjen e projekteve nën mbikëqyrjen e pedagogut të tyre për çdo lëndë përkatëse në varësi të syllabuseve (Evidenca A.3.16). Disiplina e programit të jep mundësinë për një kontakt të afërt me studentin, e cila siguron mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Format dhe metodat e mësimdhënies analizohen në mënyrë periodike duke iu referuar takimeve të vazhdueshme me studentët por si evidencë e matshme është anketimi dhe pyetësi i lidhur me mësimdhënien. Duke iu referuar <i>Evidencës A.3.24.1</i>), rezultatet e marra nga pyetësi u përcillen lektoreve për të rishikuar dhe përmirësuar lëndët. Megjithatë në mënyrë që të ketë një përmirësim në format e metodat e mësimdhënies kërkohet një pjesëmarrje më e lartë në anketim. Evidencat tregojnë një pjesëmarrje prej 12% në rang institucional dhe 13% në rang programi (<i>Evidenca A.3.24.1</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja</p>	<p>Universiteti Barleti ka struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë që ndihmon në hartimin e politikave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit të Kurrikules, (<i>Evidenca A.1.1; A.1.19</i>). <i>Sugjerohet trajnimi i vazhdueshëm i personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</i></p>

inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.									
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Gjithashtu, për një përmirësim të mëtejshëm sugjerohet trajnimi i vazhdueshëm i personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja dhe gjithashtu te siguroje rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në proceset që kanë të bëjnë me metodat e mësimdhënies.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit (<i>Evidenca A.3.2.1</i>), që duke u bazuar në takimin me studentët ato bëhen publike për ta nga institucioni.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Studentët mësojnë për objektivat e kursit, temat, materialin e detyrueshëm dhe të rekomanduar për lexim, metodën e vlerësimit dhe rezultatet e të nxënit. Metodatat e vlerësimit të lëndëve janë paraqitur në pjesën përkatëse të syllabusit. Studentët mund të shohin të gjithë numrin dhe shumëllojshmërinë e metodave të vlerësimit të aplikuara për lëndën specifike (provim, detyrë, detyra shtëpie etj.) si dhe përqindjen e secilës detyrë që ndikon në notën përfundimtare (<i>Evidenca A.3.16, Syllabuset</i>). Njohja e

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	studentit me këto specifika u konfirmua nga takimi me lektoret dhe studentët në institucion.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Këto japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë qoftë me gojë, me shkrim apo me projekte e detyra kursi. <i>(Evidenca A.3.16, Syllabuset; Aprovuar nga takimi me lektore dhe studentë)</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti Barleti dhe njësia bazë për këtë program disponon rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore. Të gjitha këto janë të parashikuara në syllabuset e lëndëve përkatëse me anë të secilave studentët njihen që në fillim të semestrit. Format e ndryshme të vlerësimit lejon studentin të demonstrojë kompetencat e fituara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kontrolli i njohurive bazohet në forma kontrolli të vazhdueshme përgjatë semestrit. Studenti e ka detyrim të frekuentoje 50% të orëve të leksioneve dhe 75% të orëve të seminareve. Detyrat dhe projektet e kursit përgjatë semestrit janë kusht për të hyrë në provimin përfundimtar që përbën 50% të formës së kontrollit. Kjo formë është efiçente për vetë karakteristikat e departamentit të arkitekturës. Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Nota kaluese është nota 5. Kjo praktikë është mëse e drejtë dhe e barasvlershme në rang kombëtar dhe më tej. Të gjitha këto janë të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. <i>(Evidenca A.3.16, Syllabuset)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të	Institucioni ka infrastrukturën e nevojshme për testimet elektronike, por kjo i është lënë në dorë lektorit nëse do ti zbatojë

testimit dhe vlerësimin, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	ose jo. Përdorimi i GOOGLECLASSROOM ofron një kontakt sa më të shpejtë me studentin por nuk shmang format e ndryshme të abuzimeve.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Pikët e akumuluar nga studenti gjatë semestrit përlogariten në notën finale. (<i>Evidenca A.3.15-Tabela 15</i>)
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive në lidhje me dorëzimet dhe prezantimet dhe komentet mbi këtë vlerësim mund të bashkëngjiten nga ana e lektorit në postën elektronike. Ndërkohë, në lëndët laboratorike (metoda specifike mësimdhënieje për këtë disiplinë), studenti merr komente në kohe reale. Kjo u konfirmua edhe nga takimi me studentë në institucion por është edhe e përcaktuar në rregulloren e programit (<i>Evidenca A.3.2.1</i>).
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Është personeli akademik që është i detyruar të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të punëve të studentëve. Puna e këtyre të fundit arkivohet në formatin digjital, gjë që bën të mundur edhe kontrollin për plagjiaturë. Ndërkohë konsultimet në lëndët laboratorike shmangin kopjimin. Megjithatë, në rast kopjimi studenti është në dijeni të penaltetit pasi kjo është e shkruar në rregulloren e programit (<i>Evidenca A.3.2.1</i>).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e provimeve dokumentohen në Procesverbalin Semestral dhe atë Vjetor, si dhe në Regjistrin e Rezultateve Akademike. Në bazë të rregullores (<i>Evidenca A.3.2.1</i>), këto procesverbale dokumentohen në sekretari jo më vonë se 5 ditë nga dita e provimit. Duke iu referuar rregullores ku theksohet që procesverbalet në fjalë nuk duhet të kenë korrigjime besojmë në transparencën e vlerësimeve. Gjithashtu nga takimet me studentët nuk u vunë në dukje pakënaqësi në këtë kriter.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në rregulloren e programit të studimit (<i>Evidenca A.3.2.1, Neni 28</i>), studenti është i njohur me të drejtën e tij/saj për tu njohur me vlerësimin dhe me të drejtën për të rishikuar vlerësimin. Procedura e kërkesës për rishikim kalon nga përgjegjësi i departamentit.



Handwritten signature in blue ink.

Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Duke iu referuar rregullores së institucionit (<i>Evidenca A.1.3, Neni 90</i>), në rast ankimimi nga ana e studentëve për vlerësim, ngrihet një komision i posaçëm, brenda 48 orëve nga koha e ankimimit, i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. I gjithë ky proces është nën vëzhgimin e dekanatit dhe procedurat janë të dokumentuara.			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Mendojmë se mund të punohet më shumë në anonimin e proceseve të vlerësimit të studentit pasi përdorimi i GOOGLECLASSROOM ofron një kontakt sa më të shpejtë me studentin por nuk shmang format e ndryshme të abuzimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Programi i Integruar i Ciklit të Dytë në Arkitekturë jep njohuritë dhe aftësitë siç tregohen nga lëndët e paraqitura në planin mësimor (<i>Evidenca A3.3.2</i>) të programit të studimit. Studentët marrin një sërë kursesh brenda disiplinave të arkitekturës, si dhe disa lëndë të tjera që lidhen me fushën e studimit. Përveç kurrikulave, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtëshkollore siç janë forumet e hapura. Plani mësimor është i ndërtuar brenda veprimtarive formuese të kërkuara nga Nr. 41, datë 24.01.2018. <i>Sugjerohet të ri-konsiderohen veprimtaritë e kategorisë (C) të këtij vendimi në lidhje me lëndët me zgjedhje.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi është në përputhje me kërkesat e programeve të integruara duke ofruar 7% të lëndëve në kategorinë (D) për të garantuar njohuri informatike, praktike dhe gjuhë të huaj. (<i>Evidenca A.3.15</i>)

<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti janë të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. Duke iu referuar takimit me drejtuesit e njësisë bazë dhe asaj kryesore konstatojmë se çdo instruktor i lëndës kryen një rishikim përfundimtar ku vlerëson njohuritë e marra, metodologjinë e përdorur dhe aspekte të tjera të rëndësishme për lëndën. <i>Evidenca:</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Duke iu referuar syllabuseve (<i>Evidenca A.3.16, Syllabuset</i>) por edhe takimeve me lektorët dhe studentët në institucion konkludojmë se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative. Përfshirja e studentëve në disa projekte dhe mobiliteti i lektorëve mundëson ndërthurjen e formave të mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit është i angazhuar në vazhdimësi me veprimtari shkencore jashtë programit të studimit. Për më shumë shikoni raportet <i>A.3.4.7</i> dhe <i>A.3.4.9</i> mbi kërkimin Shkencor.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara</p>	<p>Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovatore. Nga takimet në institucion u identifikua se Dekani i Zyrës së Studentëve u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe</p>

kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre novatore dhe aftësi të tjera.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. Sugjerohet të rikonsiderohen veprimtaritë e kategorisë (C) të vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018. në lidhje me lëndët me zgjedhje.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni ka një procedure te posaçme e cila është e detajuar në <i>Evidencën A.3.2.2.</i> Megjithatë, <i>ka një mospërputhje/mospërditësim të krediteve që theksohet në këtë procedurë (30ECTS) dhe të krediteve të paraqitura në planin mësimor (15 ECTS).</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Personeli akademik asiston studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Detyrimet e stafit akademik, shprehur në të njëjtën shtojcë (<i>Evidencën A.3.2.2.</i>), kanë si detyrë të japin udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Duke iu referuar RVB-së dhe takimeve në institucion, ky program studimi nuk ka një provim final që bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët. Programi si detyrim përmbyllës ka projekt diplome kriteret e së cilës kanë përcaktuar në raportin e Vlerësimit të Brendshëm.
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e	Udhëheqësi i diplomës, i caktuar nga departamenti ose i dakortësuar midis studentit dhe pedagogut, këshillon vazhdimisht studentit në mënyrë që të përmbushë kriteret për prezantimin final në lidhje me të gjithë elementet e nevojshme për të përmbyllur

temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	detyrimet. Udhëheqësi i tezës e vendos nëse studenti është i gatshëm të prezantojë punën e tij përpara një komisioni. (Evidenca A3.3.2, Paketa e diplomës)
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Departamenti asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit duke vënë në dispozicion aparatet e kërkuara. Kjo u vu re edhe nga vizita në institucion por është e shprehur edhe në (Evidencën A.3.2.1).
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Ne përfundim të prezantimit të temës së diplomës studentët vlerësohet nga komisioni i posaçëm me notë. (Evidenca A.3.2.1)
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentit, i cili përfundon me sukses kreditet e kërkuara si dhe mbrojtjen e diplomës, i jepet Diploma. Studentët marrin diplomën e tyre të shoqëruar me një suplement dhe me kopjen e plotë të programit të studimit. (Evidenca A.3.2.1 dhe A.3.17).
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Të gjitha dokumentet e studentëve arkivohen gjatë studimeve të tyre sipas kërkesave të direktivës së vitit përkatës dhe një kopje e tyre arkivohet edhe pas diplomimit të studentit dhe mbetet në dosjen e studentit në të njëjtën mënyrë si gjatë periudhës së studimit. Herë pas here, studentët kërkojnë lloje të ndryshme dokumentesh për të vërtetuar studimet e tyre për arsye të ndryshme. GVJ kreu një vizitë në zyrën përkatëse për të konfirmuar këtë kriter.
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. Studenti njihet</i>

	<i>me anë të rregullores për detyrimet përmbyllëse. Në të njëjtën kohë stafi akademik dhe njësia bazë angazhohet në asistimin nga ana akademike për përmbylljen e cilësisë së detyrimve përmbyllëse ashtu edhe në ofrimin e ambjenteve (laboratorëve) për kryerjen e analizave në bazë të tematikës kërkimor.</i>			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet
Kriteri 3. Praktikantët profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e	Ky kriter nuk aplikohet

trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Sipas të dhënave të vëna në dispozicion, ka personel akademik me nivelin MSc. që kontribuojnë në programin e studimit. Deri në kualifikimin e personelit në përputhje me kërkesat ligjore, kujdes i veçantë mund t'i kushtohet vitit të katërt dhe të pestë (niveli Master), lëndët e të cilit duhet të mbuloohen me personel që ka të paktën kualifikimin e ciklit të tretë të studimeve.</p> <p>Kualifikimi i personelit akademik sipas <i>Evidencës A.3.15 Tabela 6</i> është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin akademik 2019-2020 janë 12 PAE (1 Prof.Dr., 4 Dr., 7 Msc.) dhe 8 PAK (3 Dr., 5 Msc.). • Në vitin akademik 2020-2021 janë 18 PAE (1 Prof.Dr, 8 Dr., 9 Msc.) dhe 7 PAK (3 Dr., 4 Msc.). • Në vitin akademik 2021-2022 janë 17 PAE (8 Dr., 9 Msc.) dhe 4 PAK (4 Dr.). • Në vitin akademik 2022-2023 janë 16 PAE (7 Dr., 9 Msc.) dhe 4 PAK (4 Dr.). • Në vitin akademik 2023-2024 janë 13 PAE (3 Prof.As., 6 Dr., 4 Msc.) dhe 4 PAK (1 Prof.As, 3 Dr.).



<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa mësimore e personelit akademik është relativisht e lartë me një maksimum prej rreth 380 orë mësimore (E. D.). Megjithëse e lartë, kjo ngarkesë vlerësohet e përbalueshme dhe në gjykimin e GVJ nuk ndikon në cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu, ka personel akademik që mbulon deri në 7 lëndë / module (E. D., L. Sh., D. M.). Reduktimi i numrit të disiplinave që mbulon çdo mësimdhënës do të ndikonte në rritjen e mundësisë për përgatitje cilësore dhe thellim teorik dhe kërkimor.</p> <p><i>(A.3.15, Tabela 4)</i></p> <p>Sipas të dhënave të paraqitura, ngarkesa mësimore në pesë vitet e fundit është mbuluar në mbi 84% nga PAE.</p> <p><i>(A.3.15, Tabela 12)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Prej verifikimit të të dhënave në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe të dhënave të paraqitura në dokumentacionin shoqërues të RVB, rezulton se personeli akademik ka pasur ndryshime në vitet e fundit të cilat kanë sjellë përmirësim të vazhdueshëm të kualifikimit akademik. Gjithashtu, përmes kontrollit të rastësishëm të dokumentacionit rezultoi se dosjet dhe dokumentacioni ligjor përkatës mbi personelin janë të plota, duke përfshirë sigurimet shëndetësore dhe shoqërore. <i>(A.1.8)</i></p> <p><i>Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e rekrutimit përshkruhen në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore <i>(A.1.6)</i>. Procesi nis në departament dhe më pas përfshihen Sekretari i Përgjithshëm dhe Zyra e Burimeve Njerëzore. Vlerësimi paraprak i aplikantëve kryhet nga Administratori, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Zyrës së Menaxhimit dhe Administrimit të Performancës. Më pas zhvillohet vlerësimi dhe intervistimi i kandidatëve nga komisioni përkatës, i përbërë kryesisht nga drejtuesit e institucionit (Zv. Rektor, Dekan, Drejtues Departamenti etj.). Kriteret e përgjithshme për aplikim paraqiten në pikën <i>A.II të Manualit</i>.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e</p>	<p><i>Referuar A.3.15, Tabela 1, Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit nuk ka personel ndihmësakademik.</i> Nga vizita në institucion rezultoi se laboratorët administroheshin nga personeli akademik. GVJ gjykon që përfshirja e personelit ndihmësakademik është mjaft i rëndësishëm për menaxhimin e infrastrukturës dhe laboratorëve si dhe për aktivitetet e</p>

<p>mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>parashikuara në programin e studimit dhe për cilësinë e mësimdhënies në tërësi.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore ruan të dhënat për personelin akademik dhe administrativ. Të dhënat ruhen në dosjet e personelit sipas formateve standarde (A.1.8). Të dhëna mbi personelin ruhen edhe në Zyrën e Performancës. GVJ, përmes kontrolleve të rastësishme të dokumentacionit konstatoi të dhëna të plota në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti ka paraqitur një listë të gjatë marrëveshjesh me institucione të tjera që mundësojnë bashkëpunim dhe mbështetje për programin (A.3.7). Mbështetja zhvillohet edhe në kuadër të praktikave profesionale apo diplomave, kryesisht përmes studiove të projektimit dhe kompanive të ndërtimit (A.3.13).</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë</p>	<p>Paketa e praktikës profesionale është lista e dokumentacionit që rregullon marrëdhëniet mes palëve gjatë zhvillimit të praktikës. Ky proces mbikqyret nga institucioni pritës dhe zhvillohet nën mentorimin e një pedagogu nga universiteti (A.3.13). Në fund të praktikës përcillet vlerësimi për performancën e studentit sipas formularëve tip të universitetit.</p>



në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	<i>Personeli akademik me kohë të plotë mbulon 84% të orëve për programin e studimit. Numri dhe kualifikimi i personelit akademik ka ardhur në rritje. Praktikrat dhe dokumentacioni i burimeve njerëzore rezultojnë të plota. Gjithashtu është paraqitur një listë me bashkëpunorë për zhvillimin e praktikave. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit rezulton në disa raste me kualifikim jo në përputhje me kërkesat ligjore. Ndërkohë, Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit nuk ka personel ndihmësakademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Universiteti ofron një numër të mjaftueshëm klasash, studiosh, zyrash dhe hapësirash për ekspozim që janë të një cilësie shumë të mirë dhe të pajisura mirë për aktivitetet që mbulojnë. GVJ mundi të vizitojë të gjithë ambientin arsimor në Universitetin Barleti, i cili rezulton të jetë i bollshëm, cilësor dhe i pajisur mirë me mjete që ndihmojnë proceset didaktike dhe kërkimore. Një listë e detajuar e hapësirave jepet në A.3.15, Tabela 16, A.3.19, Evidenca 29, A.2.2.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e	Pajisjet elektronike si kompjuterët, projektorët etj., janë të disponueshme dhe funksionojnë plotësisht dhe janë të aksesueshme si për stafin ashtu edhe për studentët. Laboratorët mbulojnë nevojat bazike të programit. Gjatë vizitës në terren, GVJ mundi të vërejë se hapësirat e përdorura për qëllime didaktike ishin të pajisura me mjetet dhe pajisjet përkatëse, si kompjuterët, projektorët, softuerët specifikë, etj. Disa klasa kishin smartboard, të cilat janë të dobishme për komunikim më interaktiv grafik në kurset e projektimit.

<p>teknologjiive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Të dhëna të detajuara mbi pajisjet e disponueshme jepen në <i>A.3.15, Tabela 16, A.3.19, Evidenca 29.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga konstatimet e GVJ gjatë vizitës rezulton se studiot e projektimit janë të bollshme, të ndriçuara mirë dhe të pajisura me tavolina për vizatim, të përshtatshme për vizatim dhe punë me kompjuter. Konfigurimi është i përshtatshëm për punë në grup ose individuale, duke ofruar fleksibilitet përdorimi.</p> <p>GVJ mundi gjithashtu të vizitojë laboratorët e kompjuterëve dhe të modelimit që ofronin kushte të mira për punë. Laboratorë të tjerë mund të krijoheshin për të përmirësuar më tej infrastrukturën e lidhur me formimin në arkitekturë, si laborator vizatimi, laborator rilëvimi, laborator të fizikës ambientale, etj. Disa nga këto infrastruktura mund të kenë një ndikim të dyfishtë si në kurikula ashtu edhe në kërkimin shkencor.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Kampusi ka tre laboratorë kompjuterësh të dedikuar për të gjitha programet e ofruara nga universiteti. Dy prej tyre janë të shfrytëzueshëm nga studentët e arkitekturës.</p> <p>Kompjuterët janë të pajisur me programet bazë që përdorin arkitektët dhe inxhinierët. Duhet të përmendet se pothuajse të gjithë studentët kanë laptopët e tyre dhe nuk hasin probleme të lidhura me qasjen në teknologji.</p> <p>Gjithsej në laboratorë gjenden 87 kompjuterë dhe 3 videoprojektorë.</p> <p><i>(A.3.15, Tabela 16, A.3.19)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe</p>	<p>Vërejmë se ambienti didaktik në kampusin e Universitetit Barleti ofron të gjitha format e hapësirave të nevojshme për një proces akademik cilësor. Studio, auditorë leksionesh, dhoma seminari, laboratorë kompjuterësh, bibliotekë, hapësira ekspozite, etj., janë të gjitha funksionale dhe të disponueshme.</p> <p>Infrastruktura e nevojshme për praktikat profesionale arrihet në bashkëpunim me partnerë nga tregu profesional, qoftë zyra arkitekture apo kompani ndërtimi <i>(A.3.7).</i></p>

ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	<i>Infrastruktura fizike është një nga aspektet e forta të universitetit dhe të programit të studimit. Ambienti është cilësor dhe i përshtatshëm për specifikat e programit në arkitekturë. Megjithatë, mund të krijohen laboratorë të tjerë, si laborator i vizatimit, laborator i rilevimit, laborator i fizikës ambientale, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura e bibliotekës e lidhur me programin e studimit kufizohet në rreth 120 tituj, ku përfshihen botime në lidhje me arkitekturën dhe artin (<i>Dokumente plotësuese 4</i>). Ky koleksion është kryesisht në anglisht dhe në shqip. <i>Referuar A.3.15, tabela 16</i> qasja në burimet online realizohet përmes JSTOR dhe RESEARCH4LIFE të cilat janë të disponueshme për studentët dhe për stafin akademik (viti akademik 2022-2023).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Fondi aktual i bibliotekës është relativisht i vogël dhe një pjesë e konsiderueshme e tij nuk lidhet drejtpërdrejt me programin e studimit (<i>Dokumente plotësuese 4</i>). Megjithatë në RVB pohohet se ka një proces të porositjes së literaturës në fillimin e vitit akademik, GVJ nuk mundi të gjejë evidenca që dokumentojnë procesin e pasurimit të fondit të bibliotekës për programin e studimit. Nga ana tjetër, JSTOR si burim online përditësohet dhe pasurohet rregullisht. <i>GVJ inkurajon që të bëhen më shumë përpjekje për pasurimin e vazhdueshëm të fondit fizik të bibliotekës.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e	Nga konstatimet e GVJ gjatë vizitës rezulton se biblioteka është e lehtë për t'u aksesuar nga stafi dhe studentët. Ajo zhvillohet në disa ambiente të cilat ofrojnë kushte të ndryshme studimi. <i>GVJ konstatoi se përdorimi i fondit fizik të bibliotekës nga studentët e</i>

<p>shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p><i>arkitekturës ishte mjaft i ulët. Ndërkohë, frekuentimi i ambienteve për qëllime studimi rezultoi i kënaqshëm.</i> <i>GVJ inkurajon marrjen e masave për pasurimin e fondit fizik dhe lidhjen e tij me syllabuset e lëndëve si një ndihmë konkrete në cilësinë e programit, që do të rezultojë në thellimin teorik të studentëve dhe përdorimin më intensiv të bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga konstatimet e GVJ gjatë vizitës rezultoi se literatura e disponueshme është e kufizuar dhe mbështet pjesërisht përmbajtjen e programit. Librat të dedikuar për arkitekturën janë të listuar në <i>Dokumentin Plotësues 4</i>. Koleksioni, kryesisht në anglisht dhe në shqip, është gjithashtu i disponueshëm online në: https://biblioteka.umb.edu.al/genre/15/books Duke parë kufizimet që ka koleksioni fizik, <i>GVJ inkurajon pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me literaturë në fushën e arkitekturës, urbanistikës, planifikimit, peizazhit, trashëgimisë materiale, konstruksioneve, paraqitjes grafike, teknologjisë dhe materialeve të ndërtimit etj.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Qasja në burimet online realizohet përmes JSTOR dhe RESEARCH4LIFE të cilat janë të disponueshme për studentët dhe për stafin akademik (<i>A.3.15, tabela 16</i>). JSTOR ofron një gamë të gjerë titujsh dhe artikujsh në fushën e arkitekturës kryesisht në gjuhën angleze. Rinovimi i kontratës për burimet online për vitin 2024 e në vijim është i nevojshëm të realizohet nga universiteti.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ vërejti se infrastruktura ishte në kushte optimale, duke ofruar qasje të barabartë për studentët. Biblioteka ishte gjithashtu e pajisur me kompjuterë të lidhur me internetin dhe ofronte qasje në katalogun e bibliotekës. Nga ana tjetër, shumica e studentëve përdorin laptopët e tyre personale. <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion rezultoi se biblioteka ofron shërbim çdo ditë nga e hëna në të premte nga ora 8:00-19:45. Duke marrë parasysh bibliotekën si një ambient studimi, orë më të gjata funksionimi do të ishin të dobishme për studentët, veçanërisht gjatë fundjavave dhe gjatë periudhës së provimeve.</p>

<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga konstatimet e GVJ gjatë vizitës rezultojnë se literatura e disponueshme është e kufizuar dhe mbështet pjesërisht përmbajtjen e programit. Librat të dedikuar për arkitekturën janë të listuar në Dokumentin Plotësues 4. Koleksioni, është gjithashtu i disponueshëm online në: https://biblioteka.umb.edu.al/genre/15/books Duke parë kufizimet që ka koleksioni fizik, GVJ inkurajon pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me literaturë në fushën e arkitekturës, urbanistikës, planifikimit, peizazhit, trashëgimisë materiale, konstruksioneve, paraqitjes grafike, teknologjisë dhe materialeve të ndërtimit etj. GVJ, siç përshkruhet edhe më sipër, konstatoi se nevojitet një zgjerim i mëtejshëm i fondit fizik të bibliotekës i lidhur me syllabuset e programit. Gjithashtu nga të dhënat e marra gjatë vizitës në bibliotekë, rezultojnë edhe se përdorimi i fondit nga studentët është i ulët. GVJ nxit një angazhim më të madh të njësisë bazë në pasurimin e fondit të bibliotekës në lidhje me programin e studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Biblioteka shërben kryesisht si ambient studimi dhe ka kushte fizike të mira. Ambienti është i këndshëm dhe tërheqës. Biblioteka është e pajisur me akses në burime online, ndërsa koleksioni fizik në lidhje me arkitekturën është mjaft i kufizuar. Inkurajojmë departamentin që të bëjë më shumë përpjekje për të pasuruar koleksionin fizik. Nga ana tjetër, sugjerojmë administratës së universitetit të zgjerojë orët e funksionimit të bibliotekës gjatë fundjavave dhe në periudhat e provimeve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit</p>	<p>Universiteti ka sistemet e tij të brendshëm që mund të aksesohen nga studentët dhe stafi. Portali studentor është sistemi kryesor që</p>

<p>administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>mundëson aksesin e të dhënave bazë nga studenti në lidhje me procesin mësimor. Në <i>Shtojcën A.1.34</i> paraqitet Udhëzuesi për Përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit në Universitetin Barleti. Ky dokument sqaron në mënyrë të hollësishme sistemet e disponueshme dhe lehtëson aksesin e tyre nga përdoruesi.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Të dhënat që menaxhon çdo njësi dhe strukturë e universitetit mund të shkëmbehen apo aksesohen përmes rrjetit të brendshëm të komunikimit apo përmes komunikimit online. Çdo njësi ruan të dhënat e nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit. Në <i>Shtojcën A.1.34</i> paraqitet Udhëzuesi për Përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit në Universitetin Barleti. Ky dokument sqaron në mënyrë të hollësishme sistemet e disponueshme dhe lehtëson aksesin e tyre nga përdoruesi.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas përshkrimit në RVB dhe në evidencat e paraqitura si dhe mbështetur në konstatimet gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët rezultoi se portali studentor mundëson marrjen e informacionit nga studenti në lidhje me lëndët, vlerësimet, pagesat, oraret dhe komunikime të tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit mësimor (<i>A.1.34</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>U konstatua se sistemi aktual mbulon nevojat për komunikim dhe informacion dhe rezultoi të jetë efikas. Duhet theksuar se duke qenë një institucion relativisht i vogël, komunikimi mes studentëve dhe personelit të universitetit është i lehtë dhe shpeshherë i drejtpërdrejtë.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi përdorimin e Portalit Studentor si mjeti kryesor i komunikimit mes personelit akademik / administrativ dhe studentëve. Gjithashtu, universiteti përdor edhe platformën Google Classroom e cila i vjen në ndihmë komunikimit për lëndë të caktuara. Duhet theksuar se duke qenë një institucion relativisht i vogël, komunikimi mes studentëve dhe personelit të universitetit është i lehtë dhe shpeshherë i drejtpërdrejtë. (<i>A.1.34</i>) Njoftimet me email janë gjithashtu një mënyrë rutinë e komunikimit.</p>
<p>Portali studentor mundëson komunikim dhe monitorim të të dhënave nga pedagogu dhe studenti. Ndërkohë të dhëna të përgjithshme dhe statistika mund të përpunohen sipas kërkesës nga punonjësit e TI. (<i>A.1.34</i>)</p>	

raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Universiteti monitoron gjithashtu hyrje daljen e personelit përmes sistemit të kartave elektronike.		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>Faqja e internetit të universitetit ofron informacion të detajuar mbi programin si në shqip ashtu edhe në anglisht. Këto informacione që mund të aksesohen në lidhjet në vijim janë: përshkrimi i programit dhe broshura informative, informacion mbi DAD dhe rregulloret, drejtimet kryesore të aktivitetit, misioni, vizioni, strategjia, personeli akademik, aktivitetet e realizuara etj.</p> <p>https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-arkitekture.html https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/VOLANT-msc-arkitekture-upt-23.pdf https://fshaik.umb.edu.al/departamenti-i-arkitektures-dhe-dizajnit.html https://fshaik.umb.edu.al/en/departamenti-i-arkitektures-dhe-dizajnit.html</p>		
Konkluzione	<p><i>Universiteti ofron një sistem të informacionit dhe menaxhimit që shërben për të gjitha palët e përfshira në proceset akademike. Portali Studentor është mjete kryesor në përdorim nga studentët dhe akses të informacionit.</i></p> <p><i>Informacioni në web është i plotë dhe lehtësisht i aksesueshëm.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të	<p>Sipas raportit financiar të paraqitur në <i>Evidencën 6.2</i>, për programin e studimit në arkitekturë shpenzimet vjetore janë në masën 194.363 euro, ndërkohë që të ardhurat janë 217.600 euro, duke garantuar një fitim prej 23.237 euro ose 10.7%.</p> <p>Në pesë vitet e fundit, numri i studentëve ka ardhur në rritje, gjë që ka mundësuar edhe rritjen e të ardhurave.</p>

studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Gjithashtu, raporti financiar shoqërohet edhe me raportin e auditimit, i cili ilustron një situatë të shëndetshme ekonomike të institucionit.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Raporti i paraqitur në <i>Evidencën 6.2</i> përmban zërat e mëposhtëm të shpenzimeve: <ul style="list-style-type: none"> - Paga: 167.355 euro / vit - Shpenzime operationale 5.277 euro/vit - Shpenzime promocionale 4.962 euro/vit Në shpenzime nuk parashikohen të ardhura për kërkimin shkencor. Referuar të njëjtit dokument, të ardhurat bazohen vetëm tek tarifat e studentëve. Nuk ka të dhëna për grante të përfituara, të ardhura nga kontrata të shërbimeve apo projekte.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Barleti Group Sh.P.K. kryen auditim të jashtëm periodik në përputhje me legjislacionin në fuqi. Raporti i auditimit të vitit 2022 është paraqitur në <i>Evidencën 6.2</i> .
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Referuar RVB, zbatimi i politikave financiare në Universitetin Barleti bëhet nga Zyra e Financës. Duket se nuk ka përfshirje të drejtpërdrejtë të departamentit në realizimin e buxhetit. Struktura e qendëruar duket se është efikase nga pikëpamja financiare, por nuk inkurajon një organizim dhe performancë aktive dhe disi të pavarur të departamentit.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion është e vështirë të evidentohet në mënyrë të detajuar performanca ekonomike dhe financiare e universitetit. Gjithsesi, vihet re një stabilitet i vazhdueshëm dhe rritje e numrit të studentëve të cilat krijojnë bazë të shëndetshme për vijimësinë.

financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Në çdo rast, universiteti, në përbushje të misionit të tij, duhet të synojë krijimin e të ardhurave përtej tarifave të studimit, të cilat kushtëzojnë zhvillimin e aktivitetit universitar përtej mësimdhënies.			
Konkluzione	<i>Universiteti dëshmon të ketë stabilitet financiar dhe menaxhim të mirë në nivel të centralizuar. Nga ana tjetër, nuk vihet re një rol aktiv i departamentit në realizimin e buxhetit. Të ardhurat bazohen vetëm tek tarifat e studimit.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti Barleti ka hartuar bazën e dokumenteve që orientojnë dhe mundësojnë realizimin e ciklit të plotë akademik për programin e studimit, nga hyrja deri në diplomim. Këto dokumente janë: <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i universitetit (A.1.1) - Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030 (A.1.4) - Rregullorja akademike (A.1.3) - Rregullorja e programit të studimit (A.3.2.1) - Rregullorja e Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit (A.3.1)
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje	Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve të ndryshme të mbajtura, GVJ NUK vërejtë ndonjë shenjë diskriminimi,

<p>garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>paabarazie ose sjelljeje që nuk i përkiste etikës akademike. U perceptua një ambient gjithëpërfshirës, harmonik, demokratik dhe respektues si ndër studentët ashtu edhe ndër stafin akademik. Parimet bazë të respektit reciprok dhe mos diskriminimit mbështeten edhe nga dokumentet kryesore si dhe nga <i>Kodi i Etikës (A.1.5)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Procesi i pranimit ndjek udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të lëshuara për çdo vit akademik. GVJ vërejtja se informacioni mbi pranimin është i qartë dhe i aksesueshëm. Informacioni dhe procedurat e pranimit të lidhura me programin specifik janë të disponueshme në faqen e internetit të universitetit. https://umb.edu.al/zgjidh-programin-e-studimit.html https://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html https://umb.edu.al/regjistrohu.html https://umb.edu.al/transferohu.html https://umb.edu.al/tarifa-dhe-bursa.html https://umb.edu.al/zyra-e-rekrutimit-pranimit-dhe-regjistrimit.html</p> <p>Manuali për Rekrutimin, Aplikimin, Regjistrimin, Transferimin, përcakton qartë të gjithë procesin dhe fazat e pranimeve apo transferimeve (A.1.20).</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në lidhjet e mësipërme paraqiten të detajuara procedurat e pranimit, ato të transferimit dhe njohjes së studimeve. Në rregulloren e përgjithshme dhe atë të programit të studimit (A.1.3, A.3.2.1) përcaktohen format e vlerësimit të dijeve dhe mënyra e diplomimit. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm online, si dhe pranë zyrave të universitetit. Duhet pasur parasysh se për shkak të numrit të vogël të studentëve, komunikimi i drejtpërdrejtë është i lehtë dhe efikas.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p>Informacioni për studentët e mundshëm është lehtësisht i aksesueshëm në faqen e internetit të universitetit. Zyra e pranimeve ka një rol të rëndësishëm gjatë procesit të informacionit, duke ofruar mbështetje për të gjithë kandidatët e interesuar.</p>

<p>përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Pranimet bëhen sipas procedurës së mëposhtme të publikuar në web: https://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html</p> <p>Kriteret e pranimit për programet e ciklit të parë Bachelor (dhe programe të integruara të ciklit të dytë). Kriteri i pranimit për aplikim në të gjitha programet e ciklit të parë Bachelor në Universitetin “Barleti” është nota mesatare e studimeve të arsimit të lartë të mesëm, përcaktuar si nivel dhe mënyrë llogaritje sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.</p> <p>Raundi I Hapi i parë → Plotësoni formularin A1 ose A1Z në portalin www.matura.qsha.gov.al. Hapi i dytë → Brenda periudhës 10-27 korrik 2023 kryeni pagesën e tarifës së aplikimit 2,000 lekë në zyrat e Postës së Shqipërisë ose në bankat e nivelit të dytë. Hapi i tretë → Brenda periudhës 29 korrik – 3 gusht 2023 kandidati aplikon në portalin U-Albania http://ualbania.arsimi.gov.al dhe zgjedh programet e Universitetit “Barleti” si preferencë të parë. Hapi i katërt → Brenda periudhës 31 gusht – 11 shtator 2023 kandidati regjistrohet pranë Universitetit “Barleti”.</p> <p>Raundi II Hapi i parë → Plotësoni formularin A1 ose A1Z në portalin www.matura.qsha.gov.al. Hapi i dytë → Brenda periudhës 29 Gusht – 14 shtator 2023 kryeni pagesën e tarifës së aplikimit 2,000 lekë në zyrat e Postës së Shqipërisë ose në bankat e nivelit të dytë. Hapi i tretë → Brenda periudhës 15-17 shtator 2023 kandidati aplikon në portalin U-Albania http://ualbania.arsimi.gov.al dhe zgjedh programet e Universitetit “Barleti” si preferencë të parë. Hapi i katërt → Brenda periudhës 22 shtator – 01 tetor 2023 kandidati regjistrohet pranë Universitetit “Barleti”.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të</p>	<p>GVJ nuk evidentoi kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave apo shtresave të marginalizuara. Referuar https://umb.edu.al/tarifa-dhe-bursa.html universiteti ofron bursë sociale për studentin që vërteton: - statusin e jetimit;</p>

veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.	<p>- se është person me aftësi të kufizuara;</p> <p>- se ka familje me të ardhura të pamjaftueshme;</p> <p>- se është fëmijë i policit të vrarë.</p> <p>Në programin specifik të studimit nuk u identifikuan raste aplikimi bursash për këto kategori.</p>		
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Universiteti Barleti aplikon kriteret minimale të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për kandidatët nga shtetet e tjera. Këto kritere janë të njëjta si për shtetasit shqiptarë (<i>shih Kriterin 5 të këtij Standardi</i>). Në procedurat e publikuara nuk ka një përcaktim më vete për shtetasit e huaj.</p>		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Referuar https://umb.edu.al/tarifa-dhe-bursa.html Universiteti “Barleti” për t’i ardhur në ndihmë studentit ka organizuar sistemin e promovimit dhe mbështetjes financiare përmes akordimit të bursave. Bursat klasifikohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bursë ekselence një vjeçare për maturantin • Bursë merite për maturantin me merita të spikatura • Bursë sociale (<i>shih Kriterin 6 të këtij Standardi</i>) • Bursë promovimi për arritje në mësimnxënie për aplikantin/maturantin dhe studentin e UniBA-së që e ka mesataren mbi 9. <p>Bursat janë me numër të kufizuar, numri dhe vlera në total e tyre për vitin e ardhshëm akademik përcaktohet me vendim të Bordit të Administrimit. Maturantët dhe studentët e interesuar aplikojnë pranë Zyrës së Pranimit dhe Regjistrimit në Universitetin “Barleti”.</p> <p>Nëse numri i aplikimeve është më i madh se numri i bursave i akorduar nga Bordi i Administrimit, do të respektohet edhe koha e paraqitjes së aplikimit për bursë.</p>		
Konkluzione	<p><i>Universiteti ofron një kornizë të plotë politikash, rregullash dhe dokumentacionesh që mbështesin të gjithë procesin akademik, nga pranimi deri në diplomim. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm përmes faqes së internetit të universitetit.</i></p> <p><i>Kriteret e pranimit për kandidatët dhe transferimet janë të aksesueshme lehtësisht online dhe në institucion.</i></p> <p><i>Universiteti ofron edhe mbështetje me bursa për kategori të ndryshme.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.2

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

50




Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Rregullorja e përgjithshme dhe rregullorja e programit të studimit përshkruajnë me imtësi modalitetet e përparimit akademik (A.3.2.1, A.1.3).</p> <p>Gjithashtu, në kontakt të vazhdueshëm me studentët është edhe koordinatori/a i programit të studimit, që trajton problematikat specifike që ndodhin gjatë procesit mësimor.</p> <p>Studentët informohen për përparimin e tyre për kriteret dhe procedurat e vlerësimit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacionit të dhënë në klasë nga stafi pedagogjik • Informacionit të ofruar përmes zyrës së regjistrimit • Informacionit të dhënë në Departamentin e Arkitekturës dhe Dizajnit <p>Gjatë takimit me studentët, GVJ vërejtë se studentët ishin të informuar mirë.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Sipas informacionit në https://umb.edu.al/transferohu.html transferimi i studimeve kryhet përmes hapave të mëposhtëm:</p> <p>Transfero studimet në Universitetin “Barleti”</p> <p>Hapi i parë → Aplikanti dorëzon pranë Zyrës së Pranimit dhe Regjistrimit dokumentacionin për transferim, të sipërcituar.</p> <p>Hapi i dytë → Komisioni ad hoc vlerëson dosjen e aplikantit dhe kryen procesin e ekuivalentimit të krediteve.</p> <p>Hapi i tretë → Aplikanti njihet me ekuivalentimin dhe njohjen e krediteve nga ana e Komisionit.</p> <p>Hapi i katërt → Aplikanti pasi ka pranuar ekuivalentimin e krediteve, kryen çregjistrimin nga IAL-ja ku kryente studimet.</p> <p>Hapi i pestë → Aplikanti dorëzon Vërtetimin original të çregjistrimit pranë Sekretarinë Mësimore Bachelor/Master dhe mbyll procesin e regjistrimit.</p> <p>Hapi i gjashtë → Aplikanti nënshkruan Marrëveshjen me UniBa pasi ka kryer tarifën e regjistrimit/studimit.</p> <p>Pranimet për regjistrim si transferim ose në një program të dytë studimi zhvillohen në fillim të çdo viti akademik. Afatet e zhvillimit të proceseve përcaktohen me udhëzim nga MAS.</p> <p>Gjithashtu, procedurat e transferimit parashikohen edhe në Rregulloren e përgjithshme (A.1.3), Rregulloren e programit të</p>

	studimit (A.3.2.1), në Rregulloren e transferimeve (A.1.22) dhe në Manualin Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim (A.1.20).			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Referuar rregullores së programit të studimit (A.3.2.1) <i>Kreu III</i> , vlerësimi i studentit kryhet me notë (4-10), me pikë (0-100 dhe me shkronja (F-A). Format specifike të vlerësimit përcaktohen në syllabusin e çdo lënde. Përveç kontakteve me personelin akademik gjatë procesit mësimor, në kontakt të vazhdueshëm me studentët është edhe koordinatori/a i programit të studimit, që trajton problematikat specifike që ndodhin gjatë procesit mësimor.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Rregullorja e programit të studimit (A.3.2.1) <i>Kreu IV</i> , përcakton procedurën e diplomimit. Universiteti ka miratuar edhe Paketën e Provës Finale (A.3.2.2) e cila përmban procedurën e detajuar, dokumentacionin dhe udhëzime për punimin dhe dorëzimin e diplomës.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Universiteti zhvillon fushata informacioni përmes Zyrës së Pranimeve. Universiteti është gjithashtu i pranishëm në aktivitete të ndryshme vjetore për të krijuar kontakte me studentët e mundshëm.</p> <p>Faqja e internetit e universitetit ofron një përshkrim të detajuar për kandidatët e mundshëm https://admission.umb.edu.al/ https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/VOLANT-msc-arkitekture-upt-23.pdf</p> <p>Bazuar gjithashtu në rritjen e vazhdueshme të programit, mund të supozohet se interesi për programin dhe kontakti me studentët janë duke arritur një balancë të shëndetshme.</p>			
Konkluzione	<i>GVJ vërejtë se informacioni për studentët është i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm. Kjo u konfirmua gjithashtu nga vetë studentët. Sistemi i informacionit rezultoi të jetë efikas duke marrë parasysh shkallën dhe numrin e studentëve për programin specifik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

52

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vërejtë se studentët janë të informuar mirë rreth strukturës, kohëzgjatjes dhe organizimit të programit. Ata marrin informacionin përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takimeve informuese; - Koordinatorit të Departamentit; - Broshurave, guidave dhe fletëpalosjeve https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/UNIBA-BROCHURE-2024-SQ.pdf ; - Portalit Studentor; - Faqes web të universitetit. <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ vërejtë se studentët mund të aksesojnë informacionin mbi përmbajtjen e kurseve. Ata marrin informacionin përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqes së internetit të universitetit: https://umb.edu.al/upload/studime/MS-Plani-mesimor-arkitekture-upt-24.pdf - Informacionit të ofruar në Departamentin e Arkitekturës dhe Dizajnit (Koordinatori) - Informacionit të ofruar përmes Portalit Studentor <p>Më tej studentët informohen nga personeli akademik në fillim të vitit akademik, ku çdo profesor jep shpjegime dhe udhëzime të detajuara për lëndën e tij.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës është përgjegjëse për krijimin e lidhjeve me tregun e punës dhe lehtësimin e praktikave profesionale. Gjithashtu, rol informues luan edhe Dekani i Studentëve.</p> <p>Universiteti ka shumë marrëveshje me kompani dhe institucione (A.3.7, A.3.7.1) që kontribuojnë në zvogëlimin e hendekut ndërmjet akademisë dhe jetës profesionale.</p> <p>Është një fakt për të gjithë studentët e arkitekturës në Shqipëri që ata përthithen menjëherë nga tregu i punës, shpesh edhe në vitet e fundit të studimeve. Në këtë kontekst, puna institucionale bëhet më e lehtë. GVJ vërejtë se studentët janë të informuar mirë dhe janë në kontakt të vazhdueshëm me tregun e punës.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara GVJ konstatoi se informacioni mbi procesin mësimor jepet vazhdimisht nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Koordinatorin e Departamentit;

zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<ul style="list-style-type: none"> - Sekretaria Mësimore; - Dekani i Studentëve; - Personeli Akademik. <p>Komunikimi rutinë realizohet përmes emaileve apo përmes takimeve periodike.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>						
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Informacioni i përgjithshëm mbi programin e studimit është publik në faqen https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-arkitekture.html</p> <p>Përmes Portalit Studentor (A.1.34), studentët mund të informohen për notat dhe ecurinë e tyre akademike.</p> <p>Ndërkohë, për shpërndarjen e materialeve didaktike, shpeshherë është përdorur edhe Google Classroom.</p>						
Konkluzione	<p><i>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se studentët janë të informuar dhe ekzistojnë instrumentet e komunikimit të vazhdueshëm me ta. Departamenti, Koordinatorin e Departamentit, Sekretaria Mësimore, Zyra e Karrierës dhe Dekani i Studentëve, janë struktura që garantojnë mbarëvajtjen e programit të studimit si dhe komunikimin e vazhdueshëm me studentët.</i></p> <p><i>GVJ gjithashtu konstatoi se informacioni për studentët është i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm përmes sistemit të informacionit i cili rezulton funksional.</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profillin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Sekretaria mësimore mbledh dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët dhe performancën e tyre. Të dhënat mbi të diplomuarit mbahen në Zyrën e Alumnit dhe Karrierës. Të dhënat dhe statistikat zyrtare raportohet çdo vit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p><i>(A.3.15, Tabela 21 dhe 23)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për	<p>Raportet vjetore të departamentit (A.3.4.1, A.3.4.2, A.3.4.3) janë një përmbledhje e të dhënave kryesore që disponohen. Të tjera të</p>


<p>numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>dhëna dhe statistika gjithashtu mblidhen dhe përdoren në proceset e akreditimit (<i>shih RVB</i>).</p> <p>Numri i studentëve, transferimet, regjistrimet e reja dhe studentët e diplomuar gjithashtu raportohen periodikisht ose sipas kërkesës nga institucionet. Shumica e këtyre të dhënave janë përdorur për të plotësuar tabelat e <i>Shtojcës A.3.15</i>. GVJ verifikoi aksesin në kohë reale të këtyre të dhënave në zyrën e regjistrimit.</p> <p>Për 5 vitet e fundit, numri i studentëve të regjistruar (regjistrime për herë të parë + transferime) është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2019-2020: 21 studentë; - 2020-2021: 24 studentë; - 2021-2022: 30 studentë; - 2022-2023: 58 studentë; - 2023-2024: 43 studentë. <p><i>Aneks tabelat përmbledhëse, tabela 21.</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore ruan të dhënat për të gjithë studentët. Kjo përfshin statusin, notat, frekuentimin dhe informacionet e tjera të rëndësishme për avancimin e studentit. Pjesa e këtyre të dhënave është e dukshme për studentët përmes Portalit Studentor (<i>A.1.34</i>), ndërsa të tjera janë të aksesueshme nga stafi i specializuar që mund të krijojë statistika ose analiza të të dhënave.</p> <p>GVJ konstatoi gjatë vizitës se sekretaria mësimore gjithashtu ruan të dhënat zyrtare në letër, sipas formateve standarde të kërkuara.</p> <p><i>Vizita në Sekretarinë Mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p><i>Nuk u gjetën evidenca për auditim të mirëfilltë të brendshëm të njësive përbërëse të universitetit dhe dokumentacionit të ruajtur në to.</i></p> <p>Duke qenë një universitet relativisht i vogël, sekretaria mësimore është qendrore dhe procedurat që ndiqen janë të unifikuara. Proceset e akreditimit të vazhdueshme përfshijnë gjithashtu kontrollimin e dokumentacionit të zyrës së regjistrimit nga GVB dhe GVJ.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe</p>	<p>Duke qenë një universitet i vogël, sekretaria mësimore mbulon të gjitha fakultetet dhe programet. E njëjta gjë vlen edhe për Zyrën e Alumni dhe Karrierës. Të dhënat dhe raportet analitike ofrohen</p>

<p>cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>sipas kërkesës nga këto zyra për Departamentin, Fakultetin dhe Rektoratin.</p> <p>Këto zyra kontribuojnë në një seri raportesh dhe analizash që prodhohen periodikisht, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti Vjetor i Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit (A.3.4.1, A.3.4.2, A.3.4.3) - Raporti Vjetor i UniBa (A.1.30) - Të dhënat për RVB (A.3.15) - Raporti i Alumni (A.3.9) 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se të dhënat e studentëve ruhen si në formë të printuar ashtu edhe në formë digjitale. Të dhënat janë të detajuara dhe lehtësisht të aksesueshme. Ato ruhen në Sekretarinë Mësimore, si dhe në Zyrën e Alumni dhe Karrierës. Të dhënat përdoren në mënyrë periodike për vlerësime dhe analiza të brendshme. Universiteti prodhon raporte dhe analiza periodike bazuar në të dhënat e ruajtura.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Studentët përfaqësohen në organet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik (4 përfaqësues / 1 për çdo fakultet); - Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta (1 përfaqësimit pa të drejtë vote); - Komisioni i Sigurimit të brendshëm i Standardeve të Cilësisë (1 përfaqësimit); - Këshillin studentor (1 përfaqësues për çdo grup mësimor / rreth 70 gjithsej); - Dekanat (1 përfaqësues pa të drejtë vote); - Mbledhjet mujore të departamenteve. <p>(A.1.33.1, A.1.1, A1.9)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose</p>	<p><i>Shtojca A.1.33.6 jep një përshkrim të detajuar të përfshirjes së studentëve në aktivitetin e strukturave të përmendura në Kriterin 1 të këtij Standardi.</i></p>




<p>përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga takimi me studentët rezulton se ata janë të vetëdijshëm për përfaqësimin e tyre dhe e gjejnë deri diku efikase mënyrën si adresohen problemet dhe mendimet e tyre. Duhet theksuar se, duke qenë një universitet i vogël, është e lehtë që secili të dëgjohej. Universiteti rezulton të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas. <i>Takimi me Studentët.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit është në komunikim të vazhdueshëm me studentët përmes aktiviteteve mësimore. Departamenti gjithashtu analizon të dhënat e Anketës periodike (A.1.11), e cila plotësohet nga studentët çdo semestër. Duhet theksuar se, duke qenë një universitet i vogël, është e lehtë që secili të dëgjohej. Universiteti rezulton të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas.</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Referuar rregullores së universitetit (A.1.3), Neni 88 e në vijim, përcaktohen mënyrat e vlerësimit të studentit dhe mundësitë e ankimimit. Komunikimi i rezultateve bëhet në një seancë të posaçme ku studenti ka mundësi të njihet me vlerësimin dhe të shprehë mendimin e tij. Brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit, studenti ka mundësi të ankohet për rezultatit. Në këto raste, Dekani ngre një komision ad-hoc për verifikimin e rastit, i cili jep edhe vlerësimin përfundimtar. Gjatë vizitës së GVI, nuk u identifikua asnjë rast konkret ankimimi.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar mirë dhe të angazhuar në nivele të ndryshme si një pjesë e rëndësishme e universitetit dhe e programit specifik. Universiteti rezulton të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, për shkak të shkallës së vogël, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi V.6

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

57

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Universiteti ka krijuar Zyrën e Rekrutimit Pranimit dhe Regjistrimit, Zyrën e Dekanit të Studentëve dhe Zyrën e Alumnit dhe Karrierës, të cilat janë përgjegjëse për informimin dhe asistencën e studentëve për aktivitetet e përditshme brenda universitetit. Gjithashtu, Koordinatori i Departamentit është në kontakt të vazhdueshëm me studentët.</p> <p>Zyra e Dekanit të Studentëve është përgjegjëse për planifikimin, mbështetjen, mbrojtjen dhe koordinimin e programeve dhe burimeve të ndryshme edukative për studentët.</p> <p>Më hollësisht roli i këtyre strukturave përshkruhet në <i>shtojcën A.1.23</i>.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me strukturën e universitetit dhe rezultojnë të jenë të informuar mirë dhe të kënaqur me nivelin e komunikimit dhe ndihmës. Ata marrin informacionin kryesor përmes internetit dhe Portalit Studentor, i cili u mundëson atyre të aksesojnë të dhëna dhe informacionet e rëndësishme për avancimin e tyre individual në program. Nga ana tjetër, zyra mbështetëse, departamenti dhe koordinatori i departamentit duket se janë efikasë dhe të dobishëm në procesin e informimit dhe këshillimit.</p> <p>Udhëzuesi për studentët është gjithashtu një instrument i dobishëm që i ofrohet studentëve për të marrë një pasqyrë të përgjithshme të institucionit.</p> <p>https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/UNIBA-BROCHURE-2024-SQ.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe</p>	<p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës është e krijuar dhe plotësisht funksionale. Zyra është një lidhje midis akademisë dhe tregut të punës dhe organizon aktivitete periodike.</p> <p>Zyra mbështetet në rregulloren e saj (A.1.33.2), planin e punës (A.1.33.7) dhe planin strategjik (A.1.33.8) ku bazon funksionimin dhe aktivitetin e saj.</p> <p>Në rastin e programit të studimit, studentët lidhen me tregun e punës para diplomimit. Tregu i punës për arkitektët është ende i etur për profesionistë të rinj, kështu që në këtë rast, puna e zyrës së karrierës është disi më e lehtë.</p>



orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.									
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Alumnit dhe Karrierës ka të dhëna të detajuara për alumnit dhe statusin e tyre të punës dhe kryen aktivitete (A.1.33.7) dhe anketime periodike për të marrë feedback cilësor nga studentët e diplomuar. Raporti i Alumni (A.3.9) është një dokument analitik që paraqet situatën e punësimit të studentëve të diplomuar. Ky raport është i dobishëm për autoritetet e universitetit për t'u përgjigjur strategjikisht kërkesave të tregut të punës. Nga raporti i vënë në dispozicion rezulton se nga 58 studentë të diplomuar, 57 janë të punësuar dhe për 1 prej tyre nuk ka informacion. 45 janë të punësuar në sektorin privat, 8 janë të vetëpunësuar, ndërsa 4 janë punësuar në sektorin publik.								
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se universiteti ofron të gjitha strukturat e nevojshme për një ambient edukativ e funksional për studentët. Dekani i Studentëve, Zyra e Alumnit dhe Karrierës, së bashku me strukturat e departamentit, ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët e programit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të	Udhëzuesit e identifikuar nga GVJ për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies janë: - Udhëzuesi për metodat e mësimdhënies; (A.1.13)

<p>ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzuesi për përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit; (A.1.34) <p>Megjithëse nuk identifikohen metoda të veçanta të lidhura drejtpërdrejtë me karakterin e programit në Arkitekturë, këto udhëzues konsiderohen si elemente pozitive në cilësinë e mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Zyra e Performancës dhe Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë monitorojnë dhe vlerësojnë personelin akademik në aktivitetin e mësimdhënies. Këto struktura funksionojnë në bazë të rregulloreve përkatëse (A.1.17, A.1.9). Për vlerësimin e mësimdhënies aplikohen vlerësimet nga studentët (A.1.11), mes kolegëve (A.1.10), raportimi periodik mbi punën e kryer (A.1.15), kontrolli rastësor i mënyrave të vlerësimit (A.1.32) etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Studentët japin vlerësim semestral për proceset akademike përmes vlerësimit të studentëve për lëndën (A.1.11). Mbi rezultatet hartohet edhe një raport përmbledhës, i cili më pas adreson edhe gjetjet e sondazhit (A.3.24.1, A.3.24.2).</p> <p>Referuar rregullores së universitetit (A.1.3) studentët kanë të drejtë të ankimohen. Nga GVJ nuk u konstatuan raste ankimimesh gjatë takimit me studentë. Përmasat e vogla të programit të studimit mundësojnë një komunikim mjaft të mirë mes personelit akademik dhe studentëve, gjë që eviton dukshëm mekanizmin e ankimimit.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit apo raportet analitike përkatëse (A.1.29) janë publike në faqen web. Rekomandohet thellimi i analizave duke shfaqur analiza specifike (jo të përgjithshme) e duke shmangur informacione apo të dhëna që lidhen me individë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Universiteti ka ngritur një sistem të SC i cili bazohet në një seri dokumentesh e procedurash si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë; (A.1.19) - Rregullorja e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë; (A.1.9)
<p>Konkluzione</p>	<p>Gjatë vizitës në universitet dhe vlerësimit të dokumentacionit, GVJ vërejt një përpjekje të strukturuar dhe të vazhdueshme në përmirësimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Studentët gjithashtu janë të përfshirë dhe aktorë të rëndësishëm në procesin e vlerësimit.</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2


Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Referuar https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html sigurimi i brendshëm i cilësisë është procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë së UniBa. UniBa harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, kodin e cilësisë dhe praktikrat më të mira bashkëkohore.</p> <p>Sigurimi i cilësisë në UniBa është i organizuar nëpërmjet një sërë procesesh themelore që ndikojnë në realizimin e plotë të procesit akademik dhe në zhvillimin afatshkurtër e perspektiv të kurrikulave universitare që kultivohen në institucion, proceset themelore të vlerësimit të cilësisë dhe akreditimeve programore e institucionale, mbështetur në dokumentacionin ligjor të arsimit të lartë dhe aktet nënligjore, vendimeve e udhëzimeve të strukturave drejtuese të institucionit dhe në frymën e standardeve evropiane të cilësisë.</p> <p>Tre janë strukturat kryesore që janë ngritur në UniBa dhe lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë; (A.1.9) - Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë; (A.1.19) - Komisioni i vlerësimit të performancës; (A.1.17)
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Duke iu referuar <i>Rregullores së Funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Neni 4</i>, përbërja e Komisionit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Katër anëtarë nga stafi akademik; - Një përfaqësues i Studentëve. <p><i>Ky komision nuk ka përfaqësues të Alumni apo ekspertë të jashtëm të cilët do të mund të sillnin një perspektivë përtej rutinës institucionale.</i></p>

61

	Në të njëjtën kohë, Strategjia e Zhvillimit të universitetit (A.1.4) dhe akreditimet periodike janë dokumente dhe procese të rëndësishme që mbajnë aktive sistemin e Sigurimit të Cilësisë.			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti është subjekt i akreditimeve periodike institucionale dhe programore, një praktikë e vendosur prej shumë vitesh. Raportet e vlerësimit të brendshëm hartohen si pjesë e procedurës standarde, pasuar nga raportet e vlerësimit të jashtëm. Rezultatet e akreditimeve tregojnë se universiteti ka një performancë të qëndrueshme në lidhje me cilësinë e programeve, që dëshmon masa dhe mjete efikase për Sigurimin e Cilësisë.			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	<p>Performanca e stafit vlerësohet përmes deklaratimit dhe treguesve të matshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Format i raportimit të punës semestrale (A.1.15) përmban këta tregues:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Orë mësimdhënie; - Orë trajnimi; - Punë kërkimore shkencore; - Orë të angazhimit administrativ akademik; - Orë të angazhimit në aktivitete për studentët; - Orë të angazhimit administrativ korporativ; - Orë të angazhimit në qendra / institute / projekte; - Të tjera. <p>Universiteti ka edhe Rregulloren për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës (A.1.17) e cila synon qartësimin e objektivave individualë kundrejt atyre institucionalë. Në bazë të performancës, autoritetet drejtuese aplikojnë edhe promovimin institucional apo mbështetjen për aktivitetin kërkimor (kryesisht pjesëmarrje në konferenca).</p>			
Konkluzione	<i>Politikat dhe procedurat në lidhje me Sigurimin e Cilësisë janë të detajuara, efikase dhe të konsoliduara. Të tilla praktika janë integruar në punën e përditshme të stafit akademik dhe ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë së programit është përgjegjësi e Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit. Departamenti monitoron aktivitetin e përditshëm, kryen analiza periodike dhe iniciativat për ndryshime dhe përmirësime në strukturën dhe përmbajtjen e programit. Analiza e punës vjetore të departamentit dokumentohet përmes raporteve të departamentit (A.3.4.1, A.3.4.2, A.3.4.3). Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë zhvillon gjithashtu një analizë të sondazheve periodike mbi mësimdhënien (A.3.24.1).</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në bazë të vlerësimit të anketave, raportet me të dhënat dhe informacionet (A.3.24.1) dorëzohen në zyrën e performancës. Gjithashtu, si një detyrë nga proceset e akreditimit, universiteti harton plane veprimi, ku adresohen rekomandimet e bordit të akreditimit. Raporti vjetor për përmirësimin e cilësisë (A.1.29) është një ndër analizat që realizohet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Megjithëse dokumentacioni ekziston formalisht, analiza e thelluar (rezultatet e pritura, rezultatet e vlerësimeve, motivimi i praktikave më të mira dhe arritjet etj.) kryhet në punën e përditshme të departamentit dhe jo përmes proceseve të dokumentuara.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të siguruar dhe takimeve me studentët dhe stafin akademik, GVJ vërejtë se metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit janë të aplikuara për të verifikuar përparimin e studentëve dhe performancën e tyre. Këto metoda përfshijnë provimet, detyra shtëpie, teste dhe kuize, vlerësimin e punës në grupe, detyra, frekuentimin dhe pjesëmarrjen etj. Në studiot e projektimit, vlerësimi bëhet mbi punën / projektet që janë specifike për disiplinën e arkitekturës (<i>Dokument plotësues 1.4</i>). Këto janë të gjitha elemente që janë vlerësuar kryesisht nga stafi akademik.</p> <p>Ndërkohë, ekzistojnë edhe instrumente të tjera direkte si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raportimi semestral i pedagogut (<i>A.1.15</i>); - Vëzhgime në auditor (<i>A.1.10</i>); - Miratimi i tezave nga drejtuesi i departamentit (<i>A.3.22</i>).
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Metodat indirekte të vlerësimit (kryesisht anketat dhe analizat e të dhënave) përdoren për të marrë të dhëna dhe perceptime që mund të ndihmojnë në sigurimin e cilësisë së përgjithshme të programit.</p> <p>Metodat e identifikuara janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anketa e vlerësimit të studentëve (<i>A.1.11, A.3.24.1</i>); - Rezultatet e provimeve (<i>A.1.32</i>); <p>Këto analiza dhe të dhëna ndihmojnë në identifikimin e problemeve dhe mundësive për përmirësim, bazuar në perceptimet e aktorëve të ndryshëm ose në të dhënat e siguruar nga indikatorë të matshëm.</p>


Konkluzione	<i>GVJ vërejtë se departamenti dhe strukturat e universitetit të lidhura me Sigurimin e Cilësisë, kryejnë një përpjekje të vazhdueshme për të monitoruar dhe kontrolluar cilësinë e programit. Instrumentat dhe praktikatat e përdorura janë duke u konsoliduar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikatat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p><i>Duke iu referuar Rregullores së Funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Neni 4, përbërja e Komisionit është:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Katër anëtarë nga stafi akademik; - Një përfaqësues i Studentëve; <p><i>Ky komision nuk ka ekspertë të jashtëm të cilët do të mund të sillnin një perspektivë përtej rutinës institucionale. Rekomandohet përfshirja e një eksperti të jashtëm dhe përfaqësuesi nga tregu i punës për të plotësuar kuadrin e parashikuar nga SVI.4, K1 dhe SVI.2, K2.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>Referuar rregullores së universitetit (A.1.3) dhe rregulloreve të njësisve (A.1.17, A.1.19, A.1.28) përgjegjësitë dhe detyrat e njësisve për sigurimin e cilësisë janë:</p> <p>Komisioni i Vlerësimit të Performancës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizon raportet lidhur me realizimin e objektivave të performancës dhe sugjeron përmirësime; - Analizon raportet lidhur me funksionimin e strukturave dhe individëve; - Vlerëson performancën e personelit dhe atë të proceseve institucionale; - Evidenton situata konkrete dhe problematika institucionale dhe propozon masa për zgjidhjen e tyre. <p>Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Siguron orientimin, këshillimin dhe mbështetje në hartimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë;

	<ul style="list-style-type: none"> - Mbështet Njësinë e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë në lidhje me përmbushjen e standardeve të cilësisë; - Analizon detyrimet kombëtare dhe evropiane mbi sigurimin e cilësisë. <p>Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore; - Organizon pyetësonin studentor për cilësinë në mësimdhënie; - Realizon studime gjurmuese mbi punësimin e studentëve; - Propozon ndryshime në funksion të garantimit të cilësisë në përputhje me legjislacionin.
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Raporti i vlerësimit të brendshëm, pjesë e vlerësimit të cilësisë së programit, është përgatitur nga një grup i përbërë nga 6 persona që përfaqësojnë Departamentin e Arkitekturës dhe Dizajnit, administratën e universitetit dhe studentët. Të gjithë anëtarët e grupit kanë marrë pjesë në mbledhjen e të dhënave, analizën dhe hartimin e raportit, sipas pozicionit dhe kompetencave të tyre. Angazhimi i aktorëve dhe palëve të interesuara është ilustruar gjithashtu në Kriterin 1 të këtij standardi.</p> <p><i>(RVB, takimi me hartuesit e RVB)</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në universitet dhe takimeve të ndryshme që u mbajtën, GVJ konstatoi MUNGESËN e çdo shenje diskriminimi, pabarazie apo sjelljeje që nuk i përket etikës akademike. Një ambient gjithëpërfshirës, harmonik dhe respektues u perceptua si ndër studentët ashtu edhe ndër stafin akademik.</p> <p><i>Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e</p>	<p>Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit ka ngritur në vitin 2022 Bordin e Karrierës (A.3.10) të përbërë nga profesionistë të fushës së arkitekturës. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion <i>nuk kemi evidenca për angazhimin e drejtpërdrejtë të këtij bordi në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> Siç përmendet më sipër GVJ konstaton se është e nevojshme përfshirja e aktorëve</p>



studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<i>të jashtëm në proceset e vlerësimit të cilësisë, siç parashikohet edhe nga SVI.4, K1 dhe SVI.2, K2.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ ka konstatuar një ambient ku palët e përfshira në procesin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ndërveprojnë pa diskriminim apo pabarazi mes tyre. Përtej aktorëve të universitetit, nevojitet angazhimi më aktiv i Alumni, ekspertëve të jashtëm dhe përfaqësuesit e tregut të punës në strukturat e SBC si dhe në procese të ndryshme që janë të lidhura me rolin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Universiteti ka informacion të përgjithshëm mbi sigurimin e cilësisë në faqen web https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html Në këtë faqe jepet informacion për strukturat e sigurimit të cilësisë, procedurat institucionale, personelin, akreditimet, vlerësimet periodike, kontaktet, si dhe janë të disponueshme rregulloret dhe manualat.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<i>GVJ nuk arriti të gjejë informacione publike mbi rezultatet e vlerësimeve periodike të programeve të studimit.</i> Raporti vjetor i Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë (A.1.29) ndodhet në web në https://umb.edu.al/dossier-uniba.html , por ky raport nuk përmban informacion mbi rezultatet e vlerësimit të këtij programi studimi. Në të njëjtën faqe janë publikuar edhe RVB periodike të hartuara për procesin e akreditimit.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan	Raporti vjetor i Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë (A.1.29) trajton edhe hapat për t'u ndërmarrë për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Më konkretisht, në paragrafin "Mendime për

<p>masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së brendshme” ka rekomandime të përgjithshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përmirësohen programet dhe syllabuset sipas legjislacionit; - Të hartohen programe të reja studimi në përputhje me kërkesat e tregut të punës; - Pas akreditimit të programeve të studimit të hartohen plane veprimi nga njësitë bazë; - Të krijohen lehtësira për studentët që regjistrohen në raundin e parë. <p>Këto rekomandime nuk adresojnë problematika konkrete, por evidentojnë objektiva të përgjithshme. Gjithsesi, referuar këtyre rekomandimeve, njësia bazë duhet të kishte hartuar planin e veprimit për përmbushjen e rekomandimeve të akreditimit të mëparshëm. <i>Ky dokument nuk është dorëzuar nga institucioni dhe nuk përmendet në RVB.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Duhet theksuar se sistemi i Sigurimit të Cilësisë është formalisht i ngritur dhe relativisht i konsoliduar. Raportet vjetore mbi Sigurimin e Cilësisë (A.1.29), ilustrojnë metodologjinë e punës dhe qasjen gjatë një periudhe 12-mujore. Puna e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë, e kombinuar me qasjen e ndjeshme ndaj programit të departamentit, ofron mjete efektive për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Bazuar edhe në gjetjet e këtij akreditimi, <i>GVJ vlerëson se ka hapësirë për përmirësim të mëtejshëm të sistemit të SBC.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë zhvillon periodikisht trajnime dhe aktivitete që lidhen kryesisht me proceset e akreditimit. Disa prej evidencave të publikuara në faqen web të universitetit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnim në kuadër të akreditimit të programeve të studimit https://www.umb.edu.al/news4901.html; - Akreditimi i programeve të studimit në Universitetin "Barleti" https://www.umb.edu.al/news5125.html; - Trajnim në kuadër të akreditimit të programeve të studimit https://www.umb.edu.al/news5030.html; <p>GVJ vlerëson se është e nevojshme që këto veprimtari të shtrihen përtej proceseve të akreditimit, me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të sistemit të SBC tek personeli akademik dhe studentët.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se informacioni i lidhur me Sigurimin e Cilësisë është i disponueshëm dhe i aksesueshëm për të gjitha palët e interesuara.</i></p>




	<i>Megjithëse informacioni është i përgjithshëm dhe jo specifik për programin, vihet re përparim i vazhdueshëm drejt konsolidimit të sistemit të SBC.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Arkitekturë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Barleti”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Infrastruktura fizike dhe laboratorët ofrojnë një mjedis cilësor për procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
2. Shkalla e lartë e punësimit të të diplomuarve tregon përgatitje të mirë të studentëve kundrejt kërkesave të tregut të punës.
3. Rritja e numrit të studentëve në vitet e fundit dëshmon konsolidimin e programit të studimit.

Pika të dobëta

1. Universiteti përfshin në procesin mësimor personel me kualifikim jo të përshtatshëm. S. IV.1 K.1
2. Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit nuk ka personel ndihmës-akademik. S. IV.1 K.5
3. Fondi fizik i bibliotekës është mjaft i kufizuar dhe përdorimi i saj nga studentët rezulton i ulët. S.IV.3 K.2, 3, 4, 8.

Rekomandime

1. Institucioni ofron laboratorë bashkëkohorë, ndërkohë rekomandohet të punohet më shumë me kurrikulën në ofrimin e lëndëve aplikative dhe në shtimin e lëndëve me zgjedhje në këtë drejtim.
2. Rekomandohet një balancim i orëve në auditor midis semestrave.
3. Rekomandohet të garantohet anonimatit e proceseve të vlerësimit të studentit.
4. Rekomandohet të rritet përfshirja e studentëve në proceset për vlerësimin dhe përmirësimin e formave e metodave të mësimdhënies.
5. Rekomandohet trajnimi i vazhdueshëm i personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.
6. Rekomandohet të ri-konsiderohen veprimtaritë e kategorisë (C) të vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018. në lidhje me lëndët me zgjedhje.
7. Të rivlerësohet angazhimi i personelit akademik në procesin e mësimdhënies në përputhje me kualifikimin e tyre, sipas përcaktimeve të Ligjit 80/2015. Gjithashtu rekomandohet angazhimi në departament i personelit ndihmës akademik.
8. Rekomandohet pasurimi i përvitshëm i bibliotekës me literature të përditësuar sipas literaturës së syllabuseve.

9. Rekomandohet zgjatja e orareve të bibliotekës gjatë sesiont të provimeve dhe hapja e saj edhe në fundjavë.
10. Planifikimi financiar dhe realizimi i tij duhet të kryhen duke forcuar rolin e departamentit dhe duke diversifikuar burimin e të ardhurave përtej tarifave të studimit.
11. Rezultatet e vlerësimeve dhe anketimeve periodike të formave dhe metodave të mësimdhënies duhet të bëhen publike.
12. Rekomandohet përfshirja në strukturat e cilësisë e një eksperti të jashtëm dhe një përfaqësuesi nga tregu i punës për të plotësuar kuadrin e parashikuar nga SVI.4, K1 dhe SVI.2, K2.
13. Institucioni / departamenti duhet të hartojë plane veprimi specifike për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit bazuar në rezultatet e akreditimit dhe të analizave dhe vlerësimeve periodike.

Evaluation's conclusions for the integrated second cycle study program Master of Sciences in "Architecture" provided by the Higher Education Institution "Barleti University"

Strengths and affirmations

1. Physical infrastructure and laboratories offer a qualitative environment for the teaching and learning process.
2. The high employment rate of graduates indicates good preparation of students in relation to labor market demands.
3. The increase in the number of students in recent years demonstrates the consolidation of the study program.

Weaknesses


1. The university involves staff with non-appropriate qualification in the teaching process. S. IV.1 C.1
2. The Department of Architecture and Design has no academic support staff. S. IV.1 C.5
3. The physical collection of the library is quite limited, and its use by students results in being low. S.IV.3 C.2, 3, 4, 8.

Recommendation

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

1. The institution offers contemporary laboratories, while it is recommended to work with curriculum in offering practice oriented courses and at the same time to add elective courses.
2. To balance the number of hours spent by the students in the auditor between semesters.
3. It is recommended to guarantee the anonymity of the students evaluation process
4. It is recommended to increase the involvement of student in the evaluation and improvement of the teaching methods.
5. It is recommended to organize continuous trainings to academic staff to improve new teaching methods.
6. It is recommended to re-consider the activities of the category (C) of decision No. 41, dated 24.1.2018 regarding the elective courses.
7. To reevaluate the engagement of academic staff in the teaching process in accordance with their qualification, according to the provisions of Law 80/2015. It is also recommended to engage academic support staff in the department.
8. The annual enrichment of the library with literature updated according to the syllabus literature is recommended.
9. It is recommended to extend the operating hours of the library during the exam session and to open it also during weekends.
10. Financial planning and its execution should be carried out by strengthening the role of the department and diversifying revenue sources beyond tuition fees.
11. The results of periodic evaluations and surveys regarding teaching methods and forms should be made public.
12. It is recommended to include an external expert and a representative from the labor market in the quality assurance structures to complement the framework outlined in SVI.4, C1 and SVI.2, C2.
13. The institution / department must develop specific action plans for improving the quality of the study program based on the results of accreditation and periodic analyses and evaluations.

A handwritten signature in blue ink is written over a circular stamp. The stamp contains a stylized logo or set of initials, also in blue ink.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	